

# MADDO

Nr. 50, dhjetor 2025, viti i 20-të

## SUPLEMENTET +

**M** INDEXMEDIA

Çifti mediatik Rudina Xhunga dhe Dritan Hila, rrëfimi nga njohja, martesja dhe sukcesi

**M** UNIVERSITAS

Për herë të parë në THE Ranking / UET shtron rrugën drejt vlerësimeve ndërkombëtare

**M** LETERATURA

Armand Bora: Drama shqipe mes komunizmit, tranzicionit dhe sfidës moderne

**M** IMAGO

Teodor Dhoska dhe sekretet e një koleksionisti në Shqipëri


**M** MADAME

Elsa Ballauri: Shqipëria ka nevojë për dashuri

# NJERIU I VITIT 2025

**VASIL NAÇI**, një nga sipërmarresit pionerë të kapitalizmit shqiptar, që nga ditët e para të rikthimit të ekonomisë së tregut në Shqipëri në 1990, me kontribut cilësor 35 vjeçar, në kultivimin e kulturës së sipërmarrjes së lirë, përmes udhëheqjes së AGNA GROUP dhe AGNA LEADERSHIP AKADEMY

- 4 COVER STORY**  
Njeriu i vitit 2025
- 11 THE RANKING**  
UET shtron rrugën drejt vlerësimeve ndërkombëtare
- 14 STUDENTI I UET, ALVI SKITA**  
Udhëheq ekipin e Shqipërisë në European Cybersecurity Challenge
- 16 ANDONAQ LONDO LAMANI**  
Inxhinieri që iu dorëzua pa kushte auditorit
- 18 100 PORTRETE AKADEMIKËSH**  
Gjon Dyrachium rektori i parë i universitetit të parë shqiptar, 1385
- 19 ARMAND BORA**  
Drama shqipe mes komunizmit, tranzicionit dhe sfidës moderne
- 22 IVA TIÇO**  
Shijet e një lexueseje që nuk beson
- 24 PREÇ ZOGAJ**  
Shija e romanit klasik mbi një temë të njohur që na mëson të reja
- 26 100 PORTRETE SHKRIMTARËSH**  
Portreti i Parë i Kadaresë/ Lapsi i Andon Kuqalit dhe historia e një miqësie
- 27 ÇIFTI MEDIATIK**  
Xhunga dhe Dritan Hila, rrëfimi nga njohja, martesja dhe sukcesi
- 30 ALBA ALISHANI**  
Moderatorja që nuk bën kompromis me profesionin!
- 32 "L'ABANESE D'ITALIA"**  
Gazeta e parë shqiptare që zgjoi çështjen kombëtare për liri
- 34 100 PORTRETE GAZETARËSH**  
Jeronim De Rada, botuesi i parë dhe 'babai i gazetarisë' shqiptare
- 35 TEODOR DHOSKA**  
Sekretet e një koleksionisti në Shqipëri
- 38 DAVID MEÇANI**  
Piktori dhe ixhinieri atipik i kryeqytetit
- 40 "DASMA SHKODRANE"**  
Thesari i Kol Idromenos që tregon gjithçka në një kuadrat
- 42 100 FIGURA HISTORIKE NË PIKTURËN SHQIPTARE**  
Skënderbeu, hero i kombëtar në pikturën shqiptare dhe evropiane
- 43 ELSA BALLAURI**  
Shqipëria ka nevojë për dashuri
- 46 OLLGA PLUMBI**  
Gruaja që foli kundër patriarkanizmit prej 1936 e mbrojti emancipimin e gruas në komunizëm
- 46 100 GRA NË PIKTURËN SHQIPTARE**  
Motrat Zengo piktoret e para profesioniste në Shqipëri



# A do të bëjë PD në foltoren e dytë një bilanc të së parës?

PREÇ ZOGAJ  
Drejtor i MAPO



**E**vetmja sprovoj për t'u shënuar daton verën e vitit 1992, kur një grup drejtuesish e deputetësh paraqitën në Këshillin Kombëtar një analizë të gjerë të pikiatës me mbi njëzet për qind të votës proporcionale vetëm tre-katër muaj pas fitores plebishitare të 22 marsit. Analiza me emrin "mocion" u paraqit si një ftesë për diskutim në forumin më të lartë të Partisë. Në vend të debatit Berisha improvizoi brënda javës një Kuvend Kombëtar mitingashësh nën britmat e të cilëve realizoi përjashtimin nga Partia të mocionistëve dhe mbështetësve të tyre.

Hija e purgës së asaj dite në Pallatin e Kulturës i mbeti PD-së mbi kokë si shpata e Demokleut edhe kur marrëdhëniet e Neritan Cekës, Gramoz Pashkos, Arben Imamit, Arben Demetit dhe disa mocionistë të tjerë njohën, në kontakte të reja politike, periudha rikthimi në parti. E vërteta është se shizionet dhe largimet nga PD kanë vijuar parreshtuar edhe pas vitit 1992. Por shumë rrallë ka ndodhur që ikanakët të paraqisnin në forumet e partisë analiza shterruese që t'i përgjigjen pyetjes themelore: Pse humbim? Ky lloj diskutimi është fokusuar gjithmonë të parregullsitë dhe manipulimet zgjedhore nga qeveritë socialiste. Shumë pak ose aspak te arsyet që lidhen me mangësitë dhe shkaqet e brëndshme partiake, që kanë qenë po aq evidente sa parregullsitë zgjedhore. Madje PD e ka kaluar sa për të larë gojën edhe të humbjeve në zgjedhjet që ka organizuan vetë, duke u vetprivuar kësoj nga përtëritja që diktojnë humbjet.

E njëjta gjë, me sa shihet, pritet të ndodhë edhe me humbjen e thellë të zgjedhjeve parlamentare të këtij viti. Dita e mirë duket që në mëngjes, thotë shprehja popullore. Në takimin e pare, të asaj që po quhet Foltorja numër 2 e Berishës, nuk u dëgjua ndonjë gjë me rendësi që t'i vinte era analizë. Mundet që takimi në Mirditë të jetë organizuar me nxitim, si përgjigje flakë për flakë ndaj takimit që zhvilluan në Durrës Alimehmeti, Salianni dhe disa kandidatë ndër më të votuarit nga anëtarësia. Të shohim në takimet e tjera. Foltorja 2 do të ketë sens dhe vlerë piksepëri duke bërë analizën e premtimeve të foltores së parë. Çfarë u arrit dhe çfarë mbeti llafollogji?

Demokratët i mbajnë mend. Berisha i joshi me projektin e Rithemelimit të PD-së mbi parimin e votës dhe diver-

sitetit, të primareve, të sanksionimit të korentëve dhe fraksioneve, të dorëheqjes së menjëhershme të kryetarit kur humb zgjedhjet, e tjerë e tjerë. Mbi këtë bazë premtoi një parti më të madhe, me të bashkuar. Mbi të gjitha, premtoi fitoren, premtimin më joshës e mobilizues, një fjalë që demokratët kishin nisur të mendonin si mollë të ndaluar. Ata e dinë tani fatin e këtyre premtimeve. S'ka nevojë tua thotë kush. Do të ishte njëlloj si përmendja e litarit në shtëpinë e të varurit.

Gjëja më absurde e narrativës populiste- demagogjike të Rithemelimit ka qenë dhe është akoma pjesa sikur Berisha u rikthye për të shpëtuar Partinë Demokratike nga shkatërrimi. Pra të shpëtonte një Parti, cila, megjithë gjylet e dualizmit Basha-Berisha nëpër këmbë dhe manipulimet më të mëdha se asnjëherë tjetër nga PS, arriti në zgjedhjet e vitit 2021 një rrezultat ndër më të lartët e historisë së saj. Bashkë me partinë aleate LSI ishte vetëm 37 mijë vota larg PS-së. Një diferencë lehtësisht e recuperueshme përgjatë mandatit të tretë të Ramës, i njollosur nga aferat korruptive tashmë të verifikuara përmes hetimit penal.

Sa e shpëtoi Berisha partinë që ishte afër fitores katër vite më parë e tregon rrezultati katër vite pas. Diferenca PD plus LSI me Partinë Socialiste është 250 mijë vota duke llogaritur votuesit me banim në Shqipëri. Po të llogariten votuesit e diaporës diferenca shkon rreth 300 mijë.

Idenë e marrë se Partia shpëtohet duke u zvogëluar e kanë vetën ata që jetojnë mendërisht në bunkerin idelogjik të partisë unike në rregjimet njëpartiake, ku partia nuk humb gjë nga dënimet, dëbimet, përjashtimet. Përkundrazi. Pastrohet, bëhet më e fortë, sipas stilemave leniniste-enveriste. Por kjo është vetëvrasëse në demokracinë shumëpartiake. Për një parti të qendrës së djathtë në shoqërinë e hapur veprojnë "urdhëresa" të tjera të shenjta. Siç është ajo që thotë Roger Scruton, filozofi i famshëm konservator, sipas të cilit "një identitet politik forcohet përmes mosdakordësive" dhe talenti i liderit shprehet në aftësinë për të menaxhuar bashkëjetesën në diversitet. Apo sentenca tjetër "edhe sikur një njeri i vetëm të jetë në anën e kundërt me ne, pikërisht të respekti ndaj tij dhe asaj që thotë ai qëndon sistemi ynë, vlerat tona të djathta". Vendoseni këtë pasqyrë para PD-së që drejton Berisha dhe do të kup-toni sa e djathtë është.

PD është zvogëluar piksepëri nga lart poshtë. Në narrativat kontradiktore dhe premtimet futurite për ndjekësit Berisha ka ambalazhuar qartazi problemin e tij me SHBA, Britaninë e Madhe dhe Drejtësinë shqiptare. Sëpaku të kishte zgjidhur ndonjërin.

Refuzimi për të reflektuar është refuzim për të ndryshuar. Me këmbënguljen për të mos ndryshuar, PD i ka shërbyer humbjet e saj po aq sa manipulimet.



UETPRESS



500

LIBRA  
TË BOTUAR

50

LIBRA  
NË VIT

5

KOLANA

# NJERIU I VITIT 2025

VASIL NAÇI, një nga sipërmarresit pionerë të kapitalizmit shqiptar, që nga ditët e para të rikthimit të ekonomisë së tregut në Shqipëri në 1990, me kontribut cilësor 35 vjeçar, në kultivimin e kulturës së sipërmarrjes së lirë, përmes udhëheqjes së AGNA GROUP dhe AGNA LEADERSHIP AKADEMY



**R**evista Mapo në vijim të traditës mbi 20 vjeçare ka shpallur z.Vasil Naçi si personazhin e vitit 2025. Përgjatë një viti të vrullshëm me ndryshime e tallaze të forta, bordi editorial analizoi një sërë figurash dhe personalitetesh kombëtare, ku triumfoi mendimi se biznesi është ai që i jep një shtysë edhe më të fortë jo vetëm zhvillimit por edhe imazhit të vendit. Megjithatë shumë mund të ngrënë pyetje mbi këtë përzgjedhje.

Në qendër të vëmendjes të secilit prej nesh duhet të kemi vlerat për të cilat punojmë për imazhin e vendit. Në fakt marka “Glina” është krijuar 50 vite më parë ashtu sikundër kanë qenë dhe mjaft të tjera para demokracisë. Pavarësisht ndryshimit të sistemit dhe ekonomisë së vendit, “Glina” u ruajt me fanatizëm dhe vijoi të mbetet jo vetëm në tryezat shqiptare, por edhe duke u përhapur në shtete të tjera duke qëndruar si e tillë dhe si një përfaqësuese e vendit.

Një rezistencë dhe zhvillim që duhet parë si stimul për biznese dhe faktorë të tjerë social për të pasur në vëmendje jo vetëm përfitimin ekonomik, por edhe mbrojtjen e identitetit shqiptar si një element që na bashkon e na ndjen krenar sa herë e shohim në tryezat e shteteve të tjera apo dhe në tregjet ndërkombëtare.

Përballë shumë emrave të studiuar me kujdes nga bordi editorial i MAPO u zhvillua një debat i gjatë dhe i fortë mes personazheve dhe zhvillimeve të forta, por elementi përbashkues ishte se cili prej tyre mbart vlera që i tejkalon kufijtë dhe që i qëndron vlerave dhe identitetit të krijuar brenda vendit. Ndaj dhe arritja tek emrit i z.Vasil Naçi përmes zhvillimit të emrit Glina në këto 35 vite të demokracisë pa i ndryshuar vlerat e zbuluara brenda Shqipërisë erdhi krejt natyreshëm dhe me një thirrje përbashkuese për të zhvilluar traditat dhe vlerat e vendit sidomos në një kohë kur Shqipëria po i afrohet një tregu të hapur evropian

Mapo zhvilloi një intervistë me z.Naçi jo vetëm për Glinën, por dhe për atë se çfarë pritet nga Shqipëria me hapjen e negociatave dhe me afrimin drejt BE, ndikimin e inteligjencës artificiale por dhe fenomenin e

largimit të të rinjve. Për këtë të fundit z.Naçi thekson nevojën për adresimin e politikave në mënyrë që të rinjtë të qëndrojnë në vend siç e quan ai “të bekuar nga Zoti”

**1- Z.Naçi Uji Glina mbushi një gjysmë shekulli në tregun shqiptar. Shumë e kujtojnë që para vitit 1990. Çfarë ka ndryshuar në këto pesë dekada dhe a mund të themi se sot përfaqëson denjësisht Shqipërinë në tregun ndërkombëtar?**

Uji Glina prodhohet me standartet më të larta të cilësisë në fabrikën që mban emrin e ujit Glina. Magjia e Ujit Glina vazhdon: është prezent për konsumatorin shqiptar në çdo cep të Shqipërisë; është pjesë e festave, gëzimeve, ngjarjeve familjare, miqësore e shoqërore; ofron mbështetje për kulturën, artin, sportin; ofron ndihmë për grupet në nevojë; sjell risi për konsumatorët, si Glina Vitamina dhe Aranxhata. Një brand kërkon përkujdesje të veçantë dhe investime të vazhdueshme. Është një përgjegjësi e madhe për ne si Agna Group, për t’u kujdesur për këtë emër të madh - Glina, këtë mrekulli të natyrës shqiptare që është gjithashtu një pasuri kombëtare, është një xhevahiri, i lidhur ngushtë me identitetin shqiptar.

**2- A ndikon teknologjia, pra procesi i filtrimit, paketimit dhe standardeve moderne në cilësinë e produktit?**

Teknologjia luan një rol kyç në cilësinë e produktit. Proceset moderne të filtrimit, paketimit dhe standartet e avancuara të botalimit sigurojnë cilësi maksimale, ruajnë strukturën natyrore dhe mineralet, si dhe garantojnë që vetitë kurative të ujit Glina të mbërrijnë të freskëta dhe të paprekura te konsumatori. Duhet theksuar se burimi natyror është themeli i çdo uji mineral cilësor; teknologjia nuk e zëvendëson atë, por e ruan, e mbron dhe e standardizon cilësinë nga burimi deri te shishja. Pikërisht ky kombinim garanton besim dhe siguri për konsumatorin.

**3- Teknologjia dhe inteligjenca artificiale (IA) po sjellin ndryshime të forta edhe në prodhim. A është gati biznesi shqiptar për këtë transformim dhe a është përqaftuar realisht ky ndryshim?**

Sot, teknologjia dhe IA nuk janë më luks,

por armë konkurruese. Ato ndikojnë drejt-përdrejt në shpejtësinë e operimit, magazinimin, çmimin, shpërndarjen, menaxhimin e stokut dhe financave. Po aq i madh është ndikimi i tyre edhe në prodhim, përmes automatizimit, optimizimit të proceseve, planifikimit të zgjuar dhe parashikimit të saktë. Për mendimin tim biznesi shqiptar e ka përqaftuar pjesërisht këtë transformim: disa kompani po ecin shpejt, disa janë ende në fazën e parë dhe disa akoma po e mendojnë. Unë besoj se është detyrë dhe përgjegjësi e biznesit që të eci me hapin e kohës. Ai që investon sot në automatizim, teknologji dhe në IA, në njerëz dhe në kulturë inovacioni, do të fitojë tregun nesër. Pra, organizatat e biznesit duhet të kuptojnë trendet dhe të përgatiten shpejt. Këtë bëjmë edhe ne si Agna Group. Ky është një proces i pandalshëm që ndikon dhe përfshin të gjitha funksionet e biznesit. Por duke u ndalur tek prodhimi mund tju them se nëse vizitoni sot fabrikën e prodhimit të birrës Elbar, do të gjeni fjalën e fundit të teknologjisë. Çdo proces është i automatizuar dhe i perfeksionuar. Hapja e kapitujve të integritimit sjell gjithashtu detyrime për ndryshime të thella në kompanitë shqiptare.

**4- A është bërë mjaftueshëm për t’u përshtatur me rregullat evropiane? A ka konsultime, programe dhe diskutime që ndihmojnë biznesin të ecë paralelisht me këto zhvillime?**

Procesi i integritimit, pa dyshim, ushtron presion për ndryshim. Por, nëse synojmë t’u bashkohemi vendeve të BE-së, atëherë duhet të ecim në drejtimin e duhur dhe me ritmin e tyre, në standarde, procese, sisteme, mendësi dhe kulturë biznesi. Gjithsesi, hapat duhen hedhur të matur, bizneset duhet të kërkojnë konsulencë të vazhdueshme dhe programe që i ndihmojnë në mënyrë që përshtatja me rregullat evropiane të bëhet sa më natyralisht. Sigurisht, ky proces do të sjellë sfida reale, kosto, riorganizim, investime shtesë dhe ndryshim mentaliteti. Por njëkohësisht, ai hap derën për shumë mundësi të reja: akses në tregje më të mëdha dhe besueshmëri më të lartë. Duhet ta kuptojmë se integrimi nuk është



vetëm një proces politik. Është një transformim ekonomik, kulturor dhe menaxherial. Dhe ata biznese që përgatiten sot, do të jenë fituesit nesër.

**5- Zoti Naçi, hapja e kapitujve nuk është vetëm çështje përshtatjeje, por edhe tregu. Kujtojmë që me heqjen e barrierave doganore pati lëkundje në eksporte dhe importe. Tashmë, me negociatat, hapet një treg edhe më i madh, por edhe më i rrezikshëm për shkak të kostove të prodhimit në vend. Çfarë duhet ndryshuar që kompanitë shqiptare të përfitojnë realisht nga ky proces?**

Të gjitha këto procese janë të pritshme. Ne nuk mund të ndalim zhvillimin, ndryshimin dhe as të trembemi prej tij. Ajo që duhet të bëjmë është të zhvillojmë së pari mentalitetin e duhur për sukses, çka fillon duke kuptuar se ndryshimi është e vetmja gjë konstante dhe duhet ta mirëpresim duke qenë të përgatitur. Hapja drejt një tregu më të madh do të rrisë mundësitë për të gjithë, por më shumë do të përfitojnë ato kompani që përgatiten në kohë: që investojnë në teknologji, modernizojnë proceset dhe përqafojnë një mentalitet rritjeje. Pikërisht këtë synojnë edhe dy eventet që personalisht organizoj çdo vit, si pjesë e kontributit tim për komunitetin: "Rruga Drejt Suksesit" dhe "Mjeshtëro Biznesin". Ato janë ndërtuar për të ndihmuar individët dhe organizatat të përgatiten dhe të përbalen me sukses me sfidat e reja të kohës.

**6- A janë sot, pas 35 vitesh, sipërmarrësit shqiptarë shtysa kryesore e ekonomisë përmes investimeve dhe a po arrijnë të shtrijnë markat shqiptare jashtë vendit?**

Biznesi është ndikuesi kryesor në ekonominë e një vendi. Biznesi punëson, prodhon, ndikon, ndihmon, zhvillon, sjell vlerë, shërben, zgjidh probleme dhe zhvillon komunitetet. Prandaj ne si biznes dhe sipërmarrës kemi përgjegjësinë të jemi forca më e madhe e së mirës. Sa i takon shtrirjes jashtë vendit, markat shqiptare kanë potencial për të kapërcyer kufijtë. Përmirësimi i teknologjive të prodhimit, i proceseve të biznesit, i mentalitetit, i kulturës dhe ngritja e

standardeve, rrit e besueshmërisë për brandet shqiptare dhe po e bën konkurrimin ndërkombëtar gjithnjë e më të mundshëm. Proceset e integritimit do të hapin më shumë mundësi të reja, për lëvizjen më natyrale të produkteve shqiptare. Gjithashtu, komunitetet shqiptarë nëpër botë po rriten, dhe brezat që kanë ikur herët, duket se kanë mall e nostalgji për rrënjët e tyre dhe çdo gjë që është shqiptare. Në fund, pyetja nuk është "a mundemi?", por a kemi guxim të rrisim standardet, a kemi mundësinë të investojmë, të ndërtojmë besim dhe ta mbrojmë cilësinë si identitet, që markat shqiptare "Made in Albania" të mos jetë vetëm lokale, por të kërkuara kudo.

**7- Lehtësimi i lëvizjes së lirë ka sjellë edhe rritje të emigrimit. Cila është marrëdhënia e kompanive tuaja me punëmarësit?**

Sigurisht. Kjo ka qenë dhe mbetet ndër problemet më të mprehta për ne në vitet e fundit. Por në Agna Group ne kemi kultivuar prej vitesh filozofinë e "rritjes nga brenda" të punonjësve, nëpërmjet institucionit Agna Leadership Academy çka na ka ndihmuar të zhvillojmë vazhdimisht punonjës me potencial, t'u japim mundësinë të trajnohen dhe të zhvillohen, të jenë gati për të marrë më shumë përgjegjësi. Gjithashtu, një rol shumë të rëndësishëm luan edhe zhvillimi i kompanisë dhe i brandit të organizatës në tërësi. Kështu të rinjtë, apo edhe personat që janë në tregun e punës, e kanë Agnen në listën e preferencave të kompanive ku duan të punësohen.

**8- A e ndjeni mungesën e fuqisë punëtore?**

Padyshim, largimi i të rinjve plot energji dhe potencial, si edhe i personave të kualifikuar që kanë arritur pjekuri profesionale, është një humbje që dhemb dhe duhet adresuar sa më parë me politika stimuluese e shpërblyese në nivel kompleks si vlerësim, rritje dhe shpërbllim i duhur, që të mos ju shkojë në mendje të largohen, por ta gjejnë të mirën këtu, në këtë vend të bekuar që quhet Shqipëri, ku Zoti na ka falur të mira me bollëk.

**9- A mund të mbulohet tregu i punës**

**me punëtorë të huaj dhe a ka kjo një efekt negativ për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare?**

Punësimi i të huajve është një trend që po e shohim gjithnjë e më shumë në Shqipëri, në rajon dhe më gjerë, veçanërisht në sektorë si hoteleria dhe turizmi, ku kërkesa për fuqi punëtore është sezonale. Në këtë kontekst, punësimi i të huajve për shumë biznese ka rezultuar një zgjidhje e suksesshme. Megjithatë, kjo është një përgjigje afatshkurtër ndaj mungesës së fuqisë punëtore, jo një strategji afatgjatë. Si çdo zgjidhje, edhe kjo ka avantazhet dhe disavantazhet e saj, si në aspektin ekonomik ashtu edhe shoqëror. Duhet të pranojmë se jemi përballë një realiteti të ri: sot lëvizja e njerëzve mund të ngadalësohet, por nuk mund të ndalet, pavarësisht ndryshimeve ekonomike apo politike. Prandaj, sfida reale për biznesin dhe ekonominë shqiptare mbetet ndërtimi i një tregu pune më tërheqës për vendasit, investimi në aftësi, paga, përkujdesje dhe kushte më të mira, në mënyrë që punësimi i të huajve të jetë plotësues dhe jo zëvendësues i zhvillimit të brendshëm.

**10- Në fund, cili do të ishte mesazhi juaj për të rinjtë që, në vend të guximit për ta provuar në Shqipëri, shohin si rrugë më të lehtë largimin nga vendi?**

Njeriu e krijon të mirën kudo që ndodhet. Çdo gjë në jetë është zgjedhje, dhe nuk ka më bukur sesa ta ndërtosh të ardhmen aty ku ke rrënjët, tabanin dhe njerëzit që të duan pa kushte; aty ku flet dhe buzëqesh me të njëjtën gjuhë, "aty ku dera të hapet pa trokitur". Ky ishte edhe mesazhi që përcollëm përmes fushatës më të fundit të komunikimit të ujit Glina, me rastin e 50-vjetorit të tij. Shqipëria ofron më shumë mundësi sesa mendojmë. Mjafton të besojmë në këtë, të përqafojmë rritjen e pandërprerë të vetes dhe të punojmë pa rreshtur për t'u bërë më të mirë çdo ditë. Me rritjen e aftësive dhe përgatitjen tonë, mundësitë fillojnë të duken kudo, vetëbesimi rritet dhe rezistenca përballë vështirësive forcohet. Ndonjëherë e kërkojmë të mirën larg vetes, kur ajo gjendet brenda nesh.

# Uji Glina: 50 vite histori dhe konfirmim shkencor për vlerat kurative

**B**urimi i lashtë i ujit mineral Glina ndodhet në fshatin Glinë, rreth 17 km nga qyteti i Gjirokastrës. Gojëdhëna por edhe analizat shkencore tregojnë se ka veti kurative të njohura prej shekujsh.

Studiuesit austriakë të Universitetit të Gracit realizuan studimin e parë shkencor mbi përbërjen dhe përdorimin e ujit Glina në vitin 1939.

Në vitin 1948 laboratorit të Universitetit të Pragës studioi vetitë fiziko kimike të ujit mineral, ndërsa në vitin 1949 Astashkina A. publikoi studimin e parë të plotë në Shën Petërburg. Në vitin 1957 profesori i mjekësisë Agustinhski kreu një tjetër studim të rëndësishëm që tregoi qëndrueshmërinë pesëvjeçare të përbërjes së ujit.

Studimi i parë shqiptar i kryer në vitin 1969 nga Laboratori Qendror Shtetëror i Tiranës dhe Tabaku A. konfirmoi se përbërja fiziko kimike e ujit Glina mbeti e pandryshuar për dy dekada.

Instituti Kërkimor Shkencor i Frankfurtit në Gjermani përsëriti këto gjetje në vitin 1971, duke vërtetuar stabilitetin e mineralizimit. Studime të mëtejshme u kryen në vitet 1989 në Universitetin e Janinës dhe në vitin 1990 në Divizionin e Ushqimit të Kompanisë Pepsi Cola në Nju Jork, ku analizat e plota konfirmuan përbërjen e qëndrueshme. Faqja zyrtare e Glinës thekson se shishja e parë e ujit Glina u prodhua në vitin 1973 në fabrikën e famshme me të njëjtin emër, duke e bërë ujin e parë të botuar për konsum masiv në Shqipëri. Ajo funksionoi rregullisht deri në vitin 1991 kur ndryshimet politike dhe ekonomike të pas 1990 ës çuan në plaçkitjen dhe rrënimin e shumë ndërmarrjeve shtetërore, duke përfshirë fabrikën e Glinës. Në këtë periudhë fabrikës iu hoq aparatúra dhe infrastruktúra, duke e lënë ndërmarrjen në gjendje të mjerueshme dhe duke e bërë të paoperueshme deri në mesin e viteve 1990.

Kompania Alfa S.A., pjesë e Agna Group, bleu fabrikën e Glinës me vizionin e rindërtimit dhe rikthimit të ujit në treg. Si rezultat i investimit, uji i dashur i Glinës iu rikthye tryezave shqiptare dhe vetitë kurative të ujit u rikonfirmuan nga Kongresi i Pestë Mjekësor Mesdhetar në Samos, Greqi. Uji filloi eksportin në vendet europiane, duke hapur rrugën për një prezencë më të gjerë në tregjet ndërkombëtare. Gjatë më shumë se 25 viteve të fundit, fabrika e Glinës është zgjeruar nga 6 000 m<sup>2</sup> në rreth 102

000 m<sup>2</sup> dhe ka rritur kapacitetin në tetë linja prodhimi. Investimet në makineri bashkëkohore, trajnimi i stafit dhe partneritetet ndërkombëtare kanë bërë që fabrika e Glinës të arrijë standarde ndërkombëtare dhe të certifikohet me ISO 9001:2015 dhe FSSC 22000:2018.

Pas rimëkëmbjes, studimet shkencore mbi përbërjen bio kimike vazhduan dhe vërtetuan se përbërja minerale dhe vlerat ushqyese të ujit Glina mbeten të pandryshuara. Në vitin 2022 kompania lançoi për herë të parë ujin me vitamina të gazuar 'Glina Vitamina', duke kombinuar mineralet natyrore me vitamina B5, B6 dhe B12.

Në vitin 2023 Glina zgjeroni portofolin duke ringjallur pijen shqiptare 'Aranxhata' nën brandin Glina dhe duke prezantuar ujin tonik 'Glina Tonic'.

Glina mban statusin e brandit më të vjetër shqiptar në industrinë e ujit të ambalazhuar dhe simbolizon tranzicionin nga ekonomia shtetërore në një sipërmarrje private të suksesshme. Shpallja e 50 vjetorit në vitin 2024 u shoqërua me një mbrëmje gala që solli histori dhe kujtime nga konsumatorët dhe artistët, duke përforcuar rolin e Glinës në kulturën shqiptare.




# 25 LIBRA

## LETËRSIA BASHKËKOHORE SHQIPE

### PROJEKTI LETERATURA I INSTITUTIT LIBERAL PASHKO

INSTITUTI LIBERAL  
**PASHKO**  
INSTITUTI LIBERAL I TIRANËS / LIBERAL INSTITUTE OF TIRANA





# UNIVERSITAS

SUPLEMENT  
PËR ARSIMIN  
ELARTË



## World University Rankings 2025

### PËR HERË TË PARË NË THE RANKING UET shtron rrugën drejt vlerësimeve ndërkombëtare

**STUDENTI I UET**  
Alvi Skita  
udhëheq ekipin e  
Shqipërisë në  
European  
Cybersecurity  
Challenge

**ANDONAQ  
LONDO LAMANI**  
Inxhinieri që iu  
dorëzua pa  
kushte auditorit

**GJON  
DYRRACHIUM**  
Rektori i parë në  
lashtësi



# PËR HERË TË PARË NË THE RANKING

## UET shtron rrugën drejt vlerësimeve ndërkombëtare

UET hedh hapat e parë drejt renditjeve globale përmes rankimit në statusin e raportuesit në Times Higher Education, një nga platformat më prestigjioze për matjen e performancës së universiteteve në rang global.

- A e bëjmë dot?

- Nëse dikush e ka bërë, atëherë edhe ju mund ta bëni.

Ky me siguri do të ishte dialogu i themeluesve të Universitetit Europian të Tiranës me politikanin dhe motivuesin amerikan Les Brown, nëse në 2006-ën do të ndodheshin në të njëjtën tryezë diskutimi kur vendosën të lançojnë fushatën e PR për themelimin e universitetit. Vite më vonë, në festën e 15-vjetorit, ata pranuan se ajo që dukej si sfidë për shoqërinë, në fakt ishte edhe sfida e tyre personale për të ndryshuar arsimin e lartë në Shqipëri.

Dy dekada pas çeljes së dyerve të UET, ndër të parët universitete jopublike në Shqipëri, asgjë nuk është si më parë. Koha vërtetoi se po, ata mundeshin! Ky institucion transformoi arsimin e lartë përmes rritjes së cilësisë dhe standardeve akademike, multi-disiplinaritetit, shtimit të kërkimit shkencor. Ai u bë pionier kombëtar me studiuesit dhe akademikët më të njohur, me programet dhe kurrikulat më të fundit, me lidhjet dhe bashkëpunimin e fortë me tregun e punës dhe kompanitë më të njohura në vend. Prej vitesh, UET është një nga universitetet jopublike më të preferuara nga studentët shqiptar. Viti akademik 2025-2026 shënoi një numër rekord, me 2070 studentë të regjistruar në të dyja ciklet e studimit, Bachelor dhe Master.

Prej 2015-ës, kur u bë pjesë projekteve të para të Erasmus +, UET ka tejkaluar kufijtë e kombëtare dhe vijon të shtrijë rrugën drejt njohjeve evropiane dhe globale, me partneritete dhe bashkëpunime që kapërcejnë kufijtë fizikë. Në 2022-in, UET u bë institucioni i parë jopublik në Shqipëri i akredituar ndërkombëtarisht nga Agjencia për Sigurinë e Cilësisë në Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar (QAA), duke plotësuar të gjitha standardet e cilësisë dhe sigurisë, të përcaktuara në Standardet dhe Udhëzuesit Evropian.

Në vazhdim të përpjekjeve për ndërkombëtarizim, UET ndërmori një hap më ambicioz në mars të 2025-ës, duke ap-

likuar në rankimet e Times Higher Education (THE), një nga platformat më prestigjioze për matjen e performancës së universiteteve në rang global. Procesi u zhvillua përmes një pune skrupuloze në plotësimin e dokumentacionit dhe të dhënave që dëshmojnë gjithë veprimtarinë e institucionit në fushën e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies. Tregues i progresit dhe instrument i synimit të ekselencës akademike, e cilëson këtë hap rektorja e UET, Prof. Dr. Drita Kruja. “Ky proces jo vetëm rrit besueshmërinë e universiteteve shqiptare në arenën ndërkombëtare, por nxit gjithashtu përmirësimin e vazhdueshëm institucional në kërkim, mësimdhënie dhe ndikim social”, shton ajo më tej, duke shprehur se përgjigjja nga platforma ndërkombëtare do të shërbejë si katalizator drejt proceseve të reja. Në nëntor të vitit të kaluar, THE publikoi renditjet globale për 2026-ën, me universitetet më në zë sot në botë, pas një procesi 6 mujor të shqyrtimit të aplikimeve. Në këtë përpjekje të parë për të qenë në listat më të njohura të krahasimit të universiteteve, UET u rendit në statusin e reporterit, në dy kategori: WUR (World University Rankings) dhe ISR (Interdisiplinar Search Rankings). Të dyja këto rankime synojnë të dëshmojnë klimën e kërkimit shkencor, ndërkombëtarizimin, kapacitetet në infrastrukturë, në burime njerëzore, akademike dhe administrative.

Statusi i reporterit është një mekanizëm i futur nga THE në 2021-shin, për të kategorizuar gjithë institucionet që nuk arrinin të plotësonin kriterin rigoroz të publikimit në botime me reputacion të mirë të 1000 artikujve shkencorë, gjatë një periudhë pesëvjeçare. Në këtë mënyrë, edhe pse këto universitete nuk janë në listën e konkurrueshmërisë, ato njihen nga platforma si pjesëmarrës aktivë në procesin e renditjes, e për rrjedhojë të dhënat e tyre janë të dukshme dhe publike. Lëxuesit, kërkuesit dhe ndjekësit e platformës janë në gjendje të shohin gamën e gjerë të universiteteve që punojnë aktivisht për t'u shfaqur në renditje.



### **Prof. Tidita Abdurrahmani: Interdisiplinariteti, në zemër të kërkimit në UET**

THE Ranking, e cila përfshin 2,191 institucione nga 115 vende, është një nga platformat më të besueshme sot nga studentët, akademikët, qeveritë dhe ekspertët e industrisë, duke shtuar vlerën e çdo institucioni që bëhet pjesë e saj. Përveçse një mjet për të krahasuar institucionet, për të krahasuar performancën, për të identifikuar fushat e kërkimit dhe për t'i përmirësuar ato më tej, renditjet globale luajnë rol vendimtar në tërheqjen e studentëve ndërkombëtarë dhe në promovimin e sistemit të arsimit të lartë të një vendi jashtë vendit.

Përgjegjësjë e Zyrës për Ngritjen e Kapaciteteve dhe për zyrën e Kurrikulës, Prof. Asoc. Dr. Tidita Abdurrahmani, thotë se përmes kësaj renditjeje UET konsolidon pozicionin e tij si institucion i ekselencës në mësimdhënie, në kërkim dhe ndërkombëtarizim.

“THE World University Rankings vazhdon të jetë renditja kryesore ndërkombëtare që mbështet ekselencën në arsimin e lartë”, thotë pedagogia, duke shtuar se renditja përfshin 18 tregues që matin performancën e secilit institucion në pesë fusha: mësimdhënie, mjedisi kërkimor, cilësi pune kërkimore, ndërlidhje dhe bashkëpunim me industrinë dhe perspektivë ndërkombëtarizimi.

Jo më pak e vlefshme është renditja në Interdisiplinar Search Rankings (ISR), e cila bazohet në vlerësimin e angazhimit të universiteteve ndaj përsosmërisë në kërkim dhe që tejkalon kufijtë tradicionalë disiplinorë. Njëmbëdhjetë indikatorë janë në bazë të këtij rankimi, të tilla si: inputet (financimi); proceset (matjet e suksesit, mjediset, mbështetja administrative dhe promovimi); dhe rezultatet (botimet, cilësia e kërkimit dhe reputacioni).

“Interdisiplinariteti kapërcen kufijtë midis disiplinave dhe sektorëve, duke hapur rrugën për fazën tjetër në zhvil-

limin e kërkimit dhe inovacionit ndërkombëtar. Ky koncept qëndron në zemër të Universitetit European të Tiranës, i cili i kushton rëndësi të madhe nxitjes së bashkëpunimeve ndërdisiplinore me ndikim në shoqëri e më gjerë”, thekson prof. Abdurrahmani. Përveç plotësimit të vazhdueshëm të kriterëve për kalimin nga statusi i raportuesit dhe futjes në listat krahasuese të universiteteve më të mira në botë, UET synon të aplikojë vitin tjetër në THE Impact Ranking, i cili mat mbështetjen e universitetit në zhvillimin e qëndrueshëm në komunitet.

Renditja e UET në këto dy kategori të THE përforcon angazhimin e tij në cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, si dhe përforcon qasjen ndaj ndërkombëtarizimit. Nga ana tjetër, bërja pjesë e listave globale ndihmon për planifikimin strategjik, krahasimin ndërkombëtar dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së UET.

Përfshirja në renditjet e Times Higher Education përfaqëson gjithashtu një hap domethënës drejt vlerësimit objektiv të cilësisë së arsimit të lartë shqiptar, sepse rrit besueshmërinë e universiteteve shqiptare në arenën ndërkombëtare, si dhe nxit përmirësimin e vazhdueshëm institucional në kërkim, mësimdhënie dhe ndikim social.

### **Pse është i rëndësishëm rankimi në THE**

Times Higher Education (THE) është një platformë ndërkombëtare, e cila shërben si burim të dhënash, njohurish dhe ekspertizash mbi arsimin e lartë në mbarë botën. Ajo ofron të dhëna për më shumë se 7000 institucione në 171 vende, si dhe ka një audiencë vjetore me mbi 65 milionë përdorues.

Themeluar në 1971-shin në formën e një suplementi informues, gjatë viteve funksionet e saj janë zgjeruar duke e shndërruar në një institucion të rëndësishëm reference për shumë institucione akademike, qeveritare dhe ato të industrisë. Prej 2004-ës, THE ofron World University Rankings, renditjen vjetore të universiteteve më të mira botërore mbështetur në pesë kriter kryesore: mësimdhënia, mjedisi kërkimor, cilësia e kërkimit shkencor, angazhimi i industrisë, perspektiva ndërkombëtare.

Sot, THE është një nga tre platformat më prestigjioze dhe më të besueshme, e cila përveç renditjes klasike dhe më të hershme, ofron edhe renditje të tjera siç janë: rankimet ndërdisiplinore (Interdisciplinary Science Rankings), renditjet rajonale (Regional University Rankings), renditjet sipas reputacionit (Reputation Ranking), renditje sipas fushave (World University Rankings by Subject) dhe renditja sipas ndikimit (University Impact Rankings).

Ky i fundit i vlerëson universitetet bazuar në progresin e tyre drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Përmes vlerësimit në fusha të tilla si veprimi ndaj klimës, barazia gjinore apo arsimit cilësor, THE ndihmon në promovimin e një arsimit më të qëndrueshëm dhe shoqërisht të përgjegjshëm, që iu përgjigjet sfidave globale.

## Studenti i UET, Alvi Skita, udhëheq ekipin e Shqipërisë në European Cybersecurity Challenge

Për të dytin vit radhazi, Shqipëria u bë pjesë e European Cybersecurity Challenge, eventit që bashkon talentet e reja të sigurisë kibernetike nga e gjithë Evropa. Këtë vit, drejtimi i ekipit kombëtar iu besua Alvi Skitës, studentit të Inxhinierisë Informatike në Universitetit Europian të Tiranës.

**A**lvi Skita nuk është emër i panjohur. Për komunitetin e IT dhe sigurisë kibernetike ai është një personazh i spikatur me talentin dhe arritjet që ka regjistruar vitet e fundit. Për moshën e tij ato janë domethënëse, e njëkohësisht premtuese për të ardhmen.

Pjesë e disa kompeticioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, fitues i disa çmimeve, Alvi ka dëshmuar pasionin dhe vulosur pasionin në fushën e Cybersecurity. Sfida e fundit ishte më angazhuese, por edhe më e madhe për karrierën e një të riu. Edhe pse 19-vjeç, ai mori përsipër drejtimin e Ekipit Kombëtar të Sigurisë Kibernetike, i cili përfaqësoi Shqipërinë në European Cybersecurity Challenge 2025, platforma më e madhe evropiane për zbulimin dhe zhvillimin e talenteve të reja në fushën e sigurisë kibernetike.

Ajo organizohet çdo vit nga ENISA – Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike, duke mbledhur ekipet më të mira të të rinjve nga mbi 30 vende të Evropës. Përmes sfidave teknike, vihen në provë njohuritë dhe aftësitë e tyre në një mjedis ndërkombëtar të standardeve të larta.

Çdo vit ai mbahet në shtetet të ndryshme, ku përbalen skuadrat kombëtare të përbëra nga 10 të rinj të moshës 14-25 vjeç. Këtë vit eventit u mbajt në Poloni në datat 5-10 tetor. Pas njohjes dhe rrjetëzimit, konkurrentët sfidohen në zgjidhjen e detyrave të lidhura me sigurinë në fusha të tilla si siguria e web-it, siguria mobile, kriptot, dhe gjatë këtij procesi mbledhin pikë për zgjidhjen e tyre, të cilat pastaj përcaktojnë renditjen në listën finale të fituesve.

Për Shqipërinë është viti i dytë radhazi që u bë pjesë e sfidës, e cila bashkon talentet më të mira evropiane. E po ashtu, e dyta herë ishte edhe për Alvi Skitën në përfaqësimin e Shqipërisë. Ai ishte pjesë e ekipit kombëtar të vitit të kaluar ECSC 2024, i cili u zhvillua në Turin, Itali.

Këtë vit studenti i vitit të parë bachelor në programin Inxhinieri Informatike, në Universitetit Europian të Tiranës, ishte në një rol të ri, si drejtues i ekipit të Shqipërisë e përbërë nga nxënës, studentë apo të rinj nga institucione të ndryshme shqiptare. Kjo përzgjedhje për Albin e bëri rrugëtimin akoma më interesant, duke qenë se pati mundësi të ndajë eksperiencën me të rinj që aktualisht punojnë dhe studiojnë në të njëjtën fushë si ai.

Alvi e ka zbuluar herët pasionin e tij për sigurinë kibernetike, të cilin përtej pasionit, sot e ushtron si profesion në një kompani shqiptaro-franceze ku është punësuar. Ndër vite ai është bërë pjesë e disa kompeticioneve kombëtare, në të cilat është vlerësuar me çmime të para. Është shpallur fitues në konferencën vjetore për sigurinë kibernetike, BSides Tirana 2024, e cila përveçse bashkon komunitetin, diskuton çështjet e sigurisë, zhvillon edhe sfida për të rinjtë që shpërblehen me çmime dhe vlerësime të ndryshme. Fitues u shpall edhe në BSides Prishtina, zhvilluar në Universitetin e Prishtinës, si dhe i Cyber-Frontiers Hackathon të zhvilluar nga Raiffeisen Bank dhe Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Në qershor të 2025, Alvi mori çmimin Cyber Drill në eventin kryesor për inovacionin dhe teknologjinë në vendin tonë, i cili organizohet nga Këshilli Shqiptar për Teknologjinë dhe Inovacionin (ACTI) dhe bën bashkë gigantët e teknologjisë nga rajoni e bota, politikë bërësit, investitorët, startup-et dhe ekspertët e sigurisë kibernetike. Ai zgjidhi me sukses një seri skenarësh të ndërlikuar në një garë që mbledhi mbi 20 profesionistë dhe entuziastë të sigurisë kibernetike nga i gjithë vendi.

Arritjet e Alvit janë dëshmi të talentit të tij, por edhe të rëndësisë dhe pranisë në rritje të Shqipërisë në arenën e sigurisë kibernetike. Në kohën e revolucionit digjital dhe shtimin e sulmeve kibernetike, të rinj të tillë janë garanci për lundrimin në një botë të sigurt digjitale.



**E**ardhmja do t'i ndryshonte kryekëput atë mesditë të 15 gushtit të 1980-ës që si zakonisht e gjeti në krye të punës si inxhinier mekanik. Prej më shumë se gjashtë muajsh punonte në një ndërmarrje në qytetin e lindjes, Përmet, ku ishte emëruar pas mbarimit të studimeve të larta në Tiranë dhe kryerjes së shërbimit të detyruar ushtarak. Për kohën ajo konsiderohej një ndërmarrje e konsiderueshme, me 400 punëtorë, dhe merrej me riparimin e mjeteve dhe makinerive bujqësore.

Ishte mesi i fushatës së korrje-shirjes e cila mbartte përgjegjësi dhe rëndësi të veçantë, për vetë faktin se ishte një nga aktivitetet kryesore të veprimtarisë ekonomike të kohës. "Atëherë qarkullonte shprehja "12 muaj ka viti, 13 muaj është fushata", sepse bujqësia ishte në plan të parë", thotë profesori.

Po kthehej në ndërmarrje pas riparimit të autokombajnës në një fshat të zonës, kur e thërret në zyrë drejtori për t'i thënë se e kërkonin në Komitetin e Partisë. Asnjë detaj më tepër duke e lënë në mendime për arsyen e kësaj kërkese jo dhe aq të zakonshme. Lajmi që do të merrte ishte më i miri që mund të priste. "Jeni emëruar asistent pedagog në Universitetin e Tiranës dhe duhet të ndërprisni menjëherë marrëdhëniet financiare me ndërmarrjen", i komunikoi shefi i kuadrit.

"Pavarësisht gëzimit, ndjeva një farë keqardhje që do të largohesha. Kisha familjen dhe miqtë aty, e mbi të gjitha kisha filluar të ambientohesha mjaft mirë me punën e re, isha vetëm 24 vjeç", tregon Prof. Londo.

Perspektiva e një të ardhmeje më të mirë në fushën akademike ishte shtysa kryesore që pranoi vendimin. Të nesërmern mori autobusin deri në Ballsh dhe më tej trenin drejt kryeqytetit. Ishin tetë orë të gjata, të mbushura me pështjellim mendor dhe emocional për atë që po lihej pas dhe atë që e priste në të ardhmen.

Më 17 gusht u paraqit në Rektorat, mori emërimin dhe u njoh me pozicionin e ri, si asistent lektor në Universitetin Shtetëror të Tiranës, Fakultetin e Inxhinierisë në degën Mekanikë. Pavarësisht përgjegjesisë, për të ishte një ambient i njohur. Kolegët e rinj ishin pedagogët e tij të cilët e kishin rekomanduar për shkak të marrëdhënieve të mira të krijuara në kohën e studimeve, por sigurisht edhe për shkak të rezultateve të larta. Ishte diplomuar një vit më parë me mesataren 9.5 dhe vendimi i institucioneve të kohës dikton-

# ANDONAQ LONDO LAMANI

## Inxhinieri që iu dorëzua pa kushte auditorit

Dyzet e gjashtë vitet e rrugëtimit profesional e kanë gjetur si inxhinier, kërkues shkencor, drejtues fakulteti dhe së fundi drejtues universiteti si rektor i Tirana College of Technology. Mes posteve dhe përgjegjësive ndër vite, Prof. Dr. Ing. Andonaq Londo nuk ka pranuar kurrë të lërë auditorin dhe pasionin e tij për mësimdhënien.

te se nuk mund të filloje jetën akademike nëse nuk kishe bërë 5 vjet punë në prodhim, apo në institucione të tjera shtetërore. Megjithatë, kishte një përjashtim, i cili përcaktonte se 5% e studentëve që mbaronin me mesatare mbi 9 mund të mbaheshin menjëherë në universitet si asistente. Profesori Andonaq Londo iu deshën gjashtë muaj pune që të arrinte në këtë stad.

Rikthimi në Tiranë dhe në Qytetin Studenti ku kishte qëndruar si student prej shtatorit të 1974 deri në 1979, tashmë e gjeti si pedagog në konviktin mbi godinën Iliria, e destinuar për stafet akademike, të cilët qëndronin aty derisa ndërtonin familje dhe më pas dilnin në shtëpi më vete.

### Rikthimi në auditor si asistent lektor

Edhe pse universiteti filloi të hënën më 1 shtator, e enjtja do të ishte dita e përbaljes me auditorin dhe me studentët e tij të parë të degës së Mekanikës, në Fakultetin e Inxhinierisë. Shkëputja e shkurtër nga shkolla dhe udhëzimet paraprake të pedagogut përgjegjës të lëndës së Makinave Termike, ia bënë më të lehtë. Iu kishte hedhur një sy materiale gjatë qëndrimit në konvikt e më tej i kishte sjellë ndërmend në formën që do t'ua përcillte studentëve në klasë, teksa kthehej në retrospektive dhe kujtonte pedagogët e tij të dikurshëm.

Pavarësisht se preferencat e tij ishin mes matematikës, mjekësisë dhe mekanikës, kjo e fundit triumfoi kur regjimi dhe drejtuesit e kohës së qytetit ku jetonte i dhanë të drejtën e studimit. Me qasjen që kishte shteti ndaj in-

dustrializimit, ishte e natyrshme që Inxhinieria Mekanike ishte një degë e kërkuar dhe me perspektivë.

"Nuk përdor shënime në letra por shkruaj direkt në dërrasë të zezë. Këtë veçori e kam parë gjithmonë si pozitive, edhe pse të tjerë nuk e shohin ashtu", thotë profesori. Ky zakon që e shoqëroi gjatë në karrierën e tij, vijon t'i mbetet edhe sot besnik ndërsa jep leksione në Tirana College of Technology.

Për shkak të qëndrimit të gjatë në auditor dhe pranë të rinjve, e ka mjaft të lehtë të bëjë diferencën mes brezave të dy kohëve dhe të dy sistemeve krejt të ndryshme politike në Shqipëri, e mbi të gjitha të lexojë mjaft qartë se si ka ndryshuar tipologjia e studentit shqiptar.

"Studenti është produkt i kohës", thekson profesori, duke shtuar se atëherë librat ishin mjeti i vetëm i marrjes së njohurive, nuk kishte internet apo kompjuter e aq më tepër Chat GPT, sot e përdorur gjerësisht në ambientet universitare duke ngritur shqetësime serioze mbi formimin e studentëve dhe profesionistëve të ardhshëm. Literatura, mjaft cilësore për kohën dhe për fushën e studimit, ishte kryesisht në gjuhën ruse për shkak të afrimit të regjimit të kohës me ish-Bashkimin Sovjetik. Sot i referohet librave dhe studimeve që vijnë në gjuhën angleze dhe gjermane. Megjithatë, shton se lexon dhe përketen edhe nga rusishtja kur i bien në dorë materiale nga kjo gjuhë.

Por ka edhe diçka tjetër që ka ndryshuar. "Studentët atëherë ishin më të preokupuar.



Gati 70- 80% vinin e interesoheshin për detyrat dhe kishin kartela në bibliotekë”, shton profesori. Sot kjo përqindje është ulur për të mos thënë që po prek zeron, ndoshta edhe për shkak të alternativave të tjera si arkivat dhe libraritë online.

Duke iu referuar, kryesisht studentëve të Inxhinierisë Mekanike, me të cilët ka punuar më gjatë, prof. Londo thotë se dikur ishin më të motivuar për të përthithur leksionet dhe për të realizuar si duhet dhe plotësisht detyrimet akademike. Shpesh këtë e ka vërtetuar nëpërmjet detyrave të kursit. Kur e lë në vullnetin e tyre të lirë për ta gjetur vetë temën e studimit apo detyrën e kursit, vetëm 30% e studentëve e bëjnë diçka të tillë.

#### **Nga dekan i Inxhinierisë Mekanike dhe rektor i TCT-së**

Nën drejtimin e tij, Fakulteti Inxhinierisë Mekanike në UPT vijoi bashkëpunimet me

universitetet gjermane dhe i thelloi më shumë me atë të Siegenit, përmes shkëmbimeve studentore dhe të pedagogëve, realizimit të cikleve të leksioneve, punimeve të doktoraturave dhe ngritjen e laboratorëve, ende ekzistues.

Përmend si histori suksesi kalimin e studimeve në nivelin 3+2 në vitin 2006, në kuadër të përshtatjes me sistemin e Bolonjës në Fakultetin e Inxhinierisë. Së bashku me kolegët e tij te F.I.M. hartoi planet mësimore të Inxhinierisë Mekanike dhe të tre degëve të tjera që ajo përfshinte: Inxhinieria e Tekstil-it, Inxhinieria e Materialeve dhe Inxhinieria Ekonomike.

Po aq sukses cilëson hapjen e degës së Inxhinierisë Ekonomike të ngritur me ndihmën e homologëve gjermanë. “Në vitet e para të saj, në 2010-ën, e ndoqën maturantët më të mirë që kishin mbaruar shkollat e mesme, me

një mesatare të konsiderueshme mbi nëntë”, shton prof. Londo.

Po një tjetër risi në vitet e drejtimin të tij ishte realizimi i kurseve për formimin e vazhduar të inxhinierëve, të cilët kishin një diplomë të caktuar dhe më tej licensoheshin nga ministritë përkatëse, në kurset e auditimit të energjisë, në sistemet e transportit, të sigurisë rrugore etj.

Në 2016-ën mbylli etapat që parashikonin ligji sa i përket mbajtjes së postit të dekanit dhe qëndroi si profesor në Departamentin e Energjisë si shef i sektorit të makinave dhe impianteve. Ende pa mbushur moshën e pensionit, teksa jepte mësim si pedagog i jashtëm në Universitetin European të Tiranës, mori propozimin nga administratori i këtij institucioni për t’iu bashkuar me kohë të plotë.

“Kisha ende një kontratë me Politeknikun e Tiranës dhe nuk doja që ta prishja marrëveshjen me të. Ishte “dashuria ime e parë” dhe prita deri sa kontrata mbaroi”, thekson prof. Londo.

Takimi me themeluesin e Tirana College of Technology, Laert Duraj, do ta bindte që të merrte mbi supë përgjegjësinë e rektorit të këtij kolegji universitar, i cili pas dhjetë viteve të ofrimit të diplomave profesionale, solli në vitin akademik 2025-2026 edhe 4 programe të reja në ciklin bachelor.

I ka mbetur në kujtesë një bisedë me z. Duraj, të cilin e cilëson vizionar dhe të guximshëm. “Messi kur shkoi në PSG nuk vajti vetëm, mori edhe disa futbollistë të tjerë. Duam që edhe t’i të vish me ndjekësit e tu”, ishte kërkesa e tij, që shpreston ta përbushë së afërmi plotësisht.

“Duke parë dashamirësinë e Laertit unë pranova të marr përsipër këtë përgjegjësi,” thotë rektori, i bindur se projekti i Tirana College of Technology vjen pikërisht në kohën e duhur, kur teknologjia është kryefjala e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Beson se duke ndjekur këtë aset, përmes përgatitjes së profesionistëve në fushat e inxhinierive, Shqipëria do të bëhet një vend konkurrues në tregun rajonal e global me produktet e veta.

Pavarësisht ngarkesës administrative si rektor, profesor Londo nuk lë pas dorë auditorin dhe pasionin për mësimdhënien. “Më lehtë shkëputem nga detyra e rektorit sesa ajo e pedagogut. Edhe pse s’kam energjinë e dikurshme, e kompensoj me eksperiencën e 40 viteve”, shton ai me humor.



## 100 PORTRETE AKADEMIKËSH\*

Gjon Durrachium rektori i parë i niversitetit të parë shqiptar, 1385

Gjon Durrsaku ishte piktor dhe profesor i shquar i gjysmës së dytë të shekullit XIV dhe fillimit të shekullit XV. Ai ishte i biri i Domenik Durrsakut I, piktor i përmendur, dhe babai i Domenik Durrsakut II. Cilësohet si një nga personalitetet më të njohura që dolën nga Universiteti Mesjetar i Durrësit, një shkollë e lartë teologjike e themeluar nga urdhri dominikan. Në burimet historike ai përmendet si "Johannes pictor de Durachio". Përveç aktiviteteve artistike, ai njihet edhe për veprimtarinë akademike dhe u cilësua profesor në kontekstin e arsimit dominikan. Në 14 qershor 1396, Gjon Durrsaku u emërua rektori i parë i Universitas Jadertina, shkollës së re në Zadar që trashëgoi pjesërisht stafin e Universitetit të Durrësit, që emërtohej në atë kohë "STUDIS GENERALIS"

*\*Pjesë e projektit UET-UETPRESS dhe LIGA E UNIVERSITETEVE GJON DURRAHIUM për historinë e akademizmit shqiptar*



**M**

SUPLEMENT  
PËR LETËRSINË

# LETËRATURA

**IVA TIÇO**

Shijet e një lexueseje  
që nuk beson te ndarjet  
letrare sipas kombësive

**PREÇ ZOGAJ**

Shija e romanit klasik mbi  
një temë të njohur që na  
mëson të reja

**PORTRETI I PARË I KADARESE**

Lapsi i Andon Kuqalit dhe  
historia e një miqësie

## **ARMAND BORA**

Drama shqipe mes  
komunizmit, tranzicionit  
dhe sfidës moderne

# ARMAND BORA

## Drama shqipe mes komunizmit, tranzicionit dhe sfidës moderne

Përvoja e tij në teatër ka pothuaj q vjet sa Shqipëria shënon tranzicion pas rrëzimit të diktaturës dhe vetë arti skenik u çlirua nga darët e dogmës dhe censurës. Ishte viti '94 kur në teatrin "Petro Marko" të Vlorës ai vinte në skenë "Ali Pashë Tepelena", ndërsa jo shumë larg prej aty, shqiptarët dyndeshin brenda gomoneve për t'i ikur skamjes në bregun tjetër të Adriatikut.

Vepra ishte një përshtatje e dramës së francezit Jean Pierre Felicien Mallefill, por elementi shqiptar e shoqëroi gjatë gjithë karrierës. Viti 2025 e pa fitues të Çmimit Letrar Kadare me triptikun e dramave "Ata që mbijetuan" – hera e parë që ky çmim i shkoi kësaj gjinie, duke vlerësuar njëherësh autorin, por edhe si një stimul për dramën shqipe. Si dramaturg, autor i gjashtë veprave të cilat i ka ngjitur vetë në skenë përmes vizionit të regjisë së tij, Armand Bora pranon se pak është bërë për këtë gjini edhe në këta 35 vjet dhe përpjekjet për ta zhvilluar dramën shqipe mbeten individuale, sporadike.

### **Dramaturg nga nevoja, regjisor nga formimi**

Shtegu i dramaturgut është hapur nga nevoja. Dy janë rrugët- shtron ai. Ose nis e bashkëpunon me një dramaturg duke e ngacmuar, frymëzuar apo edhe orientuar drejt një teksti, ose i hyn vetë sfidës së drammatizimit. "Një eksperiencë e shpeshtë në teatrin shqiptar, që një regjisor të dramatizojë një tekst nga letërsia" – shton më tej. Kjo ndoshta ngaqë Shqipëria nuk ka pasur një shkollë të Dramaturgjisë. Në përvojën si dramaturg, i ka ardhur gjithnjë në ndihmë dimensionin si regjisor i teatrit. "Jam larguar nga genia ime si regjisor dhe kam veshur kostumin e dramaturgut, por imazhi regjisorial ka qenë gjithnjë brenda meje: e dija që shumë gjëra do të bëheshin në skenë, nuk kisha nevojë t'i shprehja në tekst.

Triptiku i dramave "Ata hyjnë pa trokitur", "Domino në Burgator" dhe "Udha e Qumështit" erdhën të botuar për lexuesin nga shtëpia botuese UET Press pasi ishin ngjitur më herët në skenë. "Ndihem mirë

Nga trashëgimia e komunizmit të krizat e modernitetit, Armand Bora analizon se si u formësua drama shqipe mes traumës historike dhe nevojës për një gjuhë të re skenike. Në përvojën e gjatë në teatër si regjisor e dramaturg ai ndalet e kujtesa e diktaturës, absurdi i tranzicionit dhe kërkimi estetik i teatrit bashkëkohor.

që patën fatin e botimit, pasi janë testuar gjatë në skenë", shton Bora.

Kanë kaluar 11 vjet kur ngjiti dyshen e aktorëve Rozi Kostani dhe Alfred Trebicka në skenën e Teatrit "Metropol" dhe prej asaj dite drama ka parë gjashtë produksione – të gjitha me regji të Borës. "Ata hyjnë pa trokitur është tekst i vështirë", pranon dramaturgu, duke shtuar se "jo të gjithë mund ta luajnë". Aktorët Kostani dhe Trebicka krijuan dy figura të cilat vendosën një standard dhe u bënë të vështirë për t'u zëvendësuar. Bashkë me dy dramat e tjera – Domino në Burgator dhe Udha e Qumështit – Bora ka krijuar një triptik që trajton periudhën e diktaturës, marrëdhënien e njeriut me sistemin, me tjetrin dhe me veten.

### **Çmitizimi i disidentit dhe absurdi i sistemit**

"Shoqëria shqiptare nuk është shkëputur nga trashëgimia e komunizmit si në aspektin politik, ashtu edhe atë shoqëror e kulturor" – thotë ai. Problemet më të theksuara Bora i sheh tek qëndrimet ideologjike, reminishente të së shkuarës, të cilat nuk mungojnë as në diskurin politik.

Stereotipat e krijuara gjatë regjimit komunist, ku kundërshtarëve politikë u mvisheshin vese janë ende të fortë.

"Por te Triptiku "Ata që mbijetuan" kam

dashur të çmitizoj edhe figurën e disidentit, të persekutuarin, sepse edhe është abuzuar pak me këtë. Në Shqipëri nuk ka pasur disidencë si në Çeki, ndoshta ngaqë regjimi ka qenë më vrastar. Kur vihej në pikëpyetje jeta, nuk diskutohej më për krijimtari, të lije dorëshkrime, mendim politik, etj. Doli një grup i madh njerëzish nga burgu që abuzuan me aureolën e disidentit."

Atë që e cilëson si thyerjen estetike e pati në fillim viteve '90, në Teatrin e Kombësive në Shkup.

"Aty rashë në kontakt me teatrin avantgardë- Teatri i Grotovskit. Më ra në duar literaturë e pa përkthyer ende në Shqipëri. Aty kam thyer për herë të parë konceptet që kisha për teatrin. Ne vinim nga një shkollë e caktuar, pedagogu Pirro Mani, po ashtu kishte studiuar atë shkollë. Sigurisht shkollë e mirë dhe bazë për të marrë esencën e teatrit klasik, pastaj gjithsecili e gjen vetë shtratin".

Thotë se vetë është tërhequr herët nga teatri absurd, edhe përpara përvojës në teatrin e Shkupit. Vepra e parë që e tërhoqi ishte "Duke Pritur Godonë".

"Këtë temë- të presësh dikë që nuk vjen, por që edhe ka ardhur ndërkohë- e kam marrë edhe në triptikun për Tranzicionin", - zbulon Bora. E ka titulluar "Duke pritur

ARMAND BORA

## ATA QË MBIJETUAN

FITUES I ÇMIMIT "KADARE" PËR VITIN 2025

Triptik / Drama



Gobonë". "Është një satirë për procesin e integritetit, që presim e presim e presim dhe asgjë nuk vjen. Është një tallje edhe me kërkesat që sapo ke përbushur një, dalin të tjera rrugës."

### Polifonia, teatri postmodern dhe thyerja e linearitetit

Eksperimentet e para i bëri me trupën "Bardhezi", të cilën e ngriti kur u kthye nga Maqedonia e Veriut. "Tentova të bëja eksperimente me teatrin antropologjik dhe polifonik dhe polifonia qëndroi brenda meje dhe është kthyer në estetikë teatrore. Edhe tek "Ata hyjnë pa trokitur" ka rikthime të tekstit, zëra paralele, skena paralele. Në një shfaqje tjetër, me tekst të Kadaresë, elementi i polifonisë ishte më i fortë, ka edhe skena paralele që zhvillohen në të njëjtën kohë, duke thyer një ligjësi të fortë të teatrit i cili ka një veprim për të mbajtur vëmendjen e publikut. Ishte dalje nga koncepti linear. Polifoninë e përdorur edhe te drama "Qejfharami ose Edipi sipas Ioneskos" – edhe kjo pjesë e triptikut të tranzicionit. Duke çmitizuar Edipin ai mbivendos portrete diktatorësh, nga Kaligula, Stalini, Hoxha e siç thotë ai, deri tek ata që ishin të tillë më 1997, kur e vendosi në skenë. Një tjetër format eksperimental siç është playback theatre e provoi me dramën "Luba" dramatizim i një teksti të

shkrimtarit Ylljet Aliçka të cilën e vuri në skenë me një brez aktorësh të rinj, duke iu rikthyer edhe njëherë temës së komunizmit. Megjithatë si dramaturg dhe regjisor, edhe në tematika si kjo, i shmanget trajtimit patetik.

"Antiheroi të shpëton" – thotë – "Njeriu i thjeshtë, i vogël, i zakonshëm, tek i cili e gjen veten kushdo" – shpjegon Bora. Thotë se lëvrimi i dramës shqipe për të nuk ka qenë thirrje patriotike. "Por ndihem mirë. Janë problematika që i njoh, që nuk e vë veten në sikletin e përfytyrimit, si e mendonin apo si silleshin qytetarët anglezë apo ata italianë te Shekspiri, jo se nuk duhen vënë edhe vepra të tilla, por duhet gjetur arsyeja, duhet të gresh pika takimi me realitetin tënd dhe mbi atë duhet ngritur përfytyrimi dhe arsyeja e vënies në skenë."

Përgjatë karrierës së tij si regjisor teatri ka punuar me një sërë tekstesh nga autorë shqiptarë.

### Drama shqipe: mes krizës, mungesës së politikave dhe nevojës për vizion

E pranon se pas viteve '90 teatri ka kaluar periudha shock-u. "Një nga sprovat e forta që kaluam si komunitet dhe teatri në veçanti ishte rendja pas funksionit argëtues."

Për të, teatri është në krizë të madhe. Teatrin Kombëtar nuk e ndërtojnë veprat e huaja, është i mendimit ai, ndërsa vë në dukje se mbizotërojnë shfaqjet me tekste të autorëve të huaj.

"Dramaturgu e bën teatrin, duam apo nuk duam. Dhe teatri shqiptar nuk e ka një profil, një fizionomi. Është alarmante! 35 vite janë shumë për të mos menduar seriozisht."

Por, shton ai, teatri mbetet hallka e fundit dhe nuk mund ta zgjidhë çështjen e dramës shqipe. Nëse nuk ka nisma jetëgjatë, nëse nuk ka festivale të dramës shqipe, konkurse, diskutime, çmime, stimuj edhe financiarë, nuk do të ketë zgjidhje të fundme.

### Modele ndërkombëtare dhe funksionet e reja të teatrit

"Bota sot teatrin e përdor për funksione të pafundme, teatër terapeutik për së-

mundje, etnoteatër për hulumtime shkencore - ti vë në skenë kërkimin tënd shkencor. Teatri përdoret edhe siç kam bërë unë me playback theatre. Ka nisur si terapeutik dhe ka shëruar njerëz nga varësi të shumta. Ka mundësi të pafundme për ta përdorur. Lexova së fundmi se në Austri mësonin gjuhë të huaja përmes teatrit, duke i kthyer tekstet e dramaturgjisë në element didaktik."

Kjo thotë ai, ndonëse jo të gjithë do të marrin në të ardhmen rrugën e artit, do të përgatiste qytetarë të kultivuar. Etnografinë performuese po përpiqet ta sjellë si metodë e leximit të ri teatror që po i bën veprës së Kadaresë "Kush e sollti Doruntinën" në tezën e disertacionit.

Dramën për herë të parë e vuri në skenë më 1999, me aktorët Neritan Liçaj e Valbona Imami, të cilën Kadare jo vetëm e pëlqeu por edhe shkroi për të në librin e tij me sprovë "Unaza në kthetra".

### Kadare në skenë: etnografi performuese dhe lexime të reja

Një nga projektet e afërta është ai i dramatizimit të romanit "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur", të cilin ka menduar ta vërë në skenë me rastin e 90 vjetorit të lindjes së shkrimtarit Ismail Kadare, më 28 janar 2026. Shqetësimi që ngre ai është se sa kohë do të ketë luftëra, do të ketë një gjeneral që mbledh eshtrat e të humburve.

"Jam i lumtur që, nga 1994 që kam vënë veprën e parë në skenë, kur kthej kokën pas jam treguar konsistent me parimet e mia estetike." Në tri dekada Armand Bora i ka prekur të gjitha skenat - nga teatri i kukullave, tek Opera. Ka eksperimentuar edhe në kinema, që në vitin 2001 me film-in "Valsi" ku ishte regjisor dhe skenarist. Pasi në teatër ka sjellë vepra me tematika nga diktatura dhe tranzicioni, thotë se ka në plan edhe një triptik për modernitetin.

Si dramaturg, me gjashtë vepra të shkruara, dhe regjisor prej 31 vitesh, thotë se do të vijojë të vërë publikun në siklet, ta trazojë, të përpiqet të bëjë atë që ka në bërthamën e tij ky art i fuqishëm – pas-trimin e brendshëm, katharsisin. "Teatri nuk është drogë, thotë në fund ai. Duhet të mbajë zgjuar natën, të ndezë diskutime, të të shqetësojë, ta alarmojë publikun.



# IVA TIÇO

## Shijet e një lexueseje që nuk beson te ndarjet letrare sipas kombësive

Iva Tiço, gazetarja e njohur dhe autorja e librit “Për vete” (UET Press), një lexuese me shije të formuar dhe zë orientues për letërsinë e mirë përmes rekomandimeve të saj flet për librat që e kanë shënjuar, mitet letrare dhe raportin e saj pa paragjykime me letërsinë

**1. Cila ka qenë vepra e parë, që keni lexuar nga letërsia shqipe dhe ç’përshlyetje ju ka lënë?**

A hyjnë klasifikim “Keci me katër këpucë” apo “Nela lepurushë”? Çufoja besoj, si të gjithë fëmijët e tetëdhjetës, një botë gazmore dhe e bukur. Por gjithsesi më duhet ta them që në fillim: jo për nihilizëm ndaj letërsisë shqiptare, por gjithmonë kam qenë e prirë të mos lexoj/shijoj sipas ndarjes shqipe - e huaj (madje e kam urreyer shkollën për këtë ndarje, sepse letërsia është letërsi dhe në trurin tim një vepër nuk vlen më shumë a më pak nga kombësia e autorit). Ndaj përpara Çufos e shumë të tjerëve librat që kanë shenjuar fëmijërinë time kane qenë ata të Zhyl Vern. Për t’u kthyer te shqipja, që besoj është qëllimi i këtij pyetësi, besoj se veprat e para që më kanë bërë përshtypje si “e rritur” kanë qenë të Kadaresë, “Ëndërr mashtruese”, përmbledhja më e rilexuar.

**2. Po vepra e fundit që keni lexuar, nga letërsia shqipe dhe ç’shije ju la ky lexim?**

“Keqkuptimi” nga Ledia Xhoga. E mora me kureshtjen për të njohur një autore shqiptare të padëgjuar kurrë në këtë botë tonë të ngushtë e që ia kishte dalë, ndërkohë, të hynte në listën e Booker Prize. Më

pëlqeu shumë, një nga ata libra që jeton gjatë brenda teje dhe pasi e ke vendosur në raft.

**3. Kush është, sipas jush, autori i mbivlerësuar i letërsisë shqipe dhe si shpjegoni?**

Për momentin nuk më vjen në mend emër, koha i shoshit. Për shembull, para pak muajsh kur po bëja zhvendosjen e shtëpisë bëra edhe një lloj pastrimi të bibliotekës që për shumëkënd është herezi. Hoqa ndër të tjera librin “Këneta” dhe aty u kujtova që Fatmir Gjata nuk ka sot vlerat e dikurshme, kur në shkollë na mësohej vetëm realizmi socialist. Kështu që kësaj pyetje do t’i përgjigjem ndoshta pas ca vitesh kur të bëj ndonjë pastrim në raftet e letërsisë së sotme.

**4. Po autori i nënvlerësuar nga letërsia shqipe?**

Krejt i nënvlerësuar jo, por për mua do duhej të ishte ai poeti jonë kombëtar: Migjeni.

**5. Kë, prej personazheve që keni krijuar, e shihni si më të realizuarin?**

Kjo besoj është pyetje për shkrimtarët “prej vërteti” sepse unë nuk kam futur as majën e gishtave në letërsi.

**6. A ka ndonjë personazh që nuk keni mundur ta krijoni?**

Henri Çili e ka krijuar para meje në kokën e tij një personazh nga ato që i kam treguar. Me merr shpesh në telefon dhe më pyet “e shkrove Uraninë?”. Ndoshta ai do shkruajë për time gjyshe para meje.

**7. Kush është heroi apo personazhi që adhuroni nga letërsia shqipe dhe**

**pse?**

Tom Kuka: një personazh jo kryesor që është i pranishëm në gjithë krijimtarinë letrare të shkrimtarit që i përdori dhe emrin për pseudonim dhe jam shumë e lumtur që ia doli mbanë të thyehte hezitimin e Enkel Demit për ta nxjerrë prej skicave e tregimeve të shkruara që në vitet kur ishte student.

**8. Po personazhi që urreni më shumë nga letërsia shqipe?**

Din Hyka, heroi i realizimit socialist që humbi këmbët në aksionin e hekurudhës dhe me këmbët e drurit që gdhendi vet ia doli të bëhej punëtor pararojë - në vend të shijonim “Aventurat e Tom Sojerit” duhet të analizonim në shkollë heroizmin e proletarit Din Hyka.

**9. Cilën vepër, nga Antologjia e Letërsisë Shqipe, e vlerësoni si më të mirën dhe pse?**

Kjo është si të thuash kë libër pëlqen më shumë dhe unë përgjigjem që ndryshon vazhdimisht.

**10. Cilën vepër do të hiqnit nga Antologjia e Letërsisë Shqipe?**

Hequr jo, por do reduktoja në programin mësimor Naim Frashërin. Ndoshta dhe e kanë bërë, por kur isha studente nuk më bënte sens që leksionet për të zgjatën disa javë ndërkohë që shumë autorë të tjerë futeshin në kategorinë “etj.,”.

**11. Përtej të qenët vetja, kujt prej shkrimtarëve botërorë do të kishit dashur t’i ngjani?**

Isabel Allende, Efik Shafak, Margaret Atwood, Lea Ypi.

# SHIJA E ROMANIT KLASIK MBI NJË TEMË TË NJOHUR QË NA MËSON TË REJA

-“Dielli në mërgim” i Ani Wilms, botuar nga “Dudaj”-

PREÇ ZOGAJ

**L**eximi i një romani voluminoz është si ti ngjitesh një mali të lartë. Të cilit i shkon në fund duke i dalë në krye. I tillë është “Dielli në mërgim” i shkrimtares shqiptare Ani Wilms.


Mora ta lexoj i ndikuar nga një shkrim i publicistit libërdashës Mero Baze, pastaj nga një ese e eseistit dhe leximtarit me sqimë të lartë, Namir Lapardhaja.

“Vizatimi idilik i jetës politike kulturore dhe sociale të Vlorës, Durrësit apo Tiranës në vitet 40, përballja e shqiptarëve me antisemitizmin dhe ngjyrat e pafundme përmes të cilës kaloi miti i mbrojtjes së hebrenjve nga shqiptarët, që nga ai më i thjeshti deri tek ministrat është një histori që mund ta tregoj vetëm letërsia tani për tani”, shkruante Baze. Një pohim që evidenton “zonat” ekskluzive të letërsisë, siç janë fjala vjen përplasjet e të drejtave përjashtuese të njëra tjetrës në një periudhë të dhënë apo në gjithkohë.

Në këto përplasje-konflikte letërsia hyn dhe përparon me mjetin e rrëfimit të ngjarjeve, me përthyerjen e tyre në sferën e perceptimeve, botëkuptimeve dhe botëndijimeve diverse të personazheve, ku pozicionimet apo rreshtimet e individëve apo palëve i përgjigjen një ontologjie vetjake të grupit shoqëror apo një ideologjie të caktuar. Në vetvete këto pozicionime nuk janë domosdoshmërisht kriminale, por humbëse ose fituese, të gabuara ose të drejta në perspektiven e tyre në kohë dhe sidomos në dritën e humanizmit.

Për ta ilustruar këtë persiatje me subjektin e romanit “Dielli në mërgim”: Jo vetëm familjet e thjeshta shqiptare i mbrojtën hebrenjtë, por edhe qeveritë e tyre kolaboracioniste apo kuislinge nën pushtim. Në të vërtetë familjet e thjeshta nuk do të mund t’i mbronin dot po të mos u jepte një dorë a të mos mbyllnin sytë qeveritë “tradhëtare”. Fakti godet dogmat e historiografisë sektare. Këtu hyn letërsia që bën drejtësi në sferën e epërme të postngjarjeve, humanrs, shpirtërores.

Në romanin e Wilms, rregjistrin të antagonizmave me



karakter klasor sikurse atyre që lidhen me qëndrimin ndaj pushtimit e luftës çlirimtare, u brëndashkruhet përmes sagës familiare të familjes “Jakoeli” fati i hebrenjve të vendosur herët apo të ardhur rishtas në Shqipëri për t’u shpëtuar kampeve naziste të zhdukjes.

Mund të thuhet edhe e kundërta: Sagës se familjes Jakoeli ne qëndër të romanit, që shpaloset kryesisht përmes Jozefit, personazhit qëndror të romanit, u brëndashkruhet regjistri i antagonizmave të lartpërmendur.

Megjithëse Jakoelët dhe familjet e tjera hebrenje i përkasin një shtrese të pasur, ata mbështesin luftën antifash-



iste nacionalçlirimtare. Vetë Jozefi del në mal si pjesë e formacioneve partizane. Si për ironi të fatit, ndërsa u shpëtuan tentakulave naziste gjatë luftës, me instalimin në pushtetet të komunistëve hebrenjtë e Shqipërisë do t'i presë kalvari i falimentimit përmes tatimit të jashtëzakoshëm, shpronësimit të dhunshëm, harrimit në burgje, dëbimit brutal nga shtëpitë e tyre.

Lexesit i duhet lenë kërshëria t'i zbulojë vetë fatet e personazheve nepër episode tronditëse të një periudhe autentike të historisë sonë.

Në këtë përcjellje dua t'u bëj me dije se "Dielli në perëndim" është një roman klasik i llojit të tablosë, me disa linja në strukturë dhe narrativë, kur episodet ndjekin rendin e rrëfimit linear dhe plotësojnë si pazëlla tërësinë e tij.

Shkrimtarja demonstron një njohje të thelluar të subjektit. Duket qartë se ajo është përgatitur, ka studiuar, e ka "rindërtuar" në laboratorin e saj krijues kuadrin kohor të ngjarjeve në Vlorën, Tiranën, Durrësin dhe vende të tjera të viteve dyzet-pesëdhjetë të shekullit të kaluar. Ajo njeh në thellësi historinë e jashtëzakonshme të popullit hebre, zakonet, fenë, ritet e tij të shenjta, fatin tragjik, holokastin, specifikat e jetës së komuniteteve hebreje në vende të ndryshme të Europës. Ka mbledhur më shumë lëndë se sa do t'i nevojitej, siç thoshte Floberi. "Dielli në mërgim nuk ndjek "trendet moderne" të romaneve ku varfëria e lëndës jetësore shkapërcehet me sajime arbitrare, lidhje të shkurtera, ormamente të kërkuara. Shkrimtarja mikson dhe shkrin brënda unitetit artistik të veprës realen me trillimin. Romani i saj ilus-

tron sentencën se proza e mirë është ajo kur realja i ngjan trillimit dhe trillimi jetësorës. Vertetësia dhe koloriti artistik marrin jetë nga fjalori i pasur, nga aftësia e për të përcjellë në gjuhë gjendje shpirtërore subtile, dramatike apo të errëta, nga fuqia përshkruese e skenave dhe mjedisëve ku shohim një Vlorë kontrastesh me ishuj klasi e begatie që nuk e kishim njohur aq mirë, nga dialogjet funksionale, nga suspansat e përligjigjura, nga një optikë estetike, që vigjelon faqe pas faqeje në gjithë librin.

"Romani nuk mund të lexohet vetëm si një histori e luftës dhe e pasluftës në Shqipëri, si një rrëfim për vajtjen e hebrenjve apo si një sagë familjare. Ai është më shumë se kaq..

Në të vertetë kur e mbaron se lexuari, klisheja e romanit për shpëtimin e hebrenjve të duket "e varfër" në shtrijen që merr përgjatë shtjellimit romanesk të episodeve e fateve njerëzore- hebrenj dhe shqiptarë, djem dhe zonjusha, burra dhe gra, me klas të lartë apo të zakonshëm, të pasur apo të varfër, ballistë nacionalistë apo partizanë. Në këtë galeri spikat perzonazhi i vajzës së emancipuar me klas të lartë, Aulona Gega. Fati tragjik i saj godet në roman si dëshmia emblematike e çfarë vendi humbi përgjatë dekadave të stalinizmit. Duke sjellë në roman shkrimtarja e kthen në pedestal si për të provuar me një shembull pikant se për të marrë hakun e krimeve dhe padrejtësive të tmerrshme në fund mbetet letërsia.

Si përfundim, mund të themi se "Dielli në mërgim" rikthen shijen e romanit klasik të tabllës mbi një temë të njohur në pamje të parë, por që na mëson plot të reja. Siç është në zakonet e letërsisë së mirë.



## 100 PORTRETE SHKRIMTARËSH\*

### Portreti i Parë i Kadaresë/ Lapsi i Andon Kuqalit dhe historia e një miqësie

Vizatimi me laps i Ismail Kadaresë, realizuar nga Andon Kuqali në vitin 1957, është një nga portretet më të hershme të shkrimtarit dhe dëshmi e një miqësie që do të zgjaste dekada. Ai u krijua gjatë Kongresit të Parë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, kur të dy ishin në fillimet e tyre krijuese. Kuqali e fikson Kadarenë në një çast të natyrshëm, me një vijë të shpejtë dhe të sigurt, duke kapur përqendrimin dhe energjinë e brendshme të tij. Portreti, i realizuar me laps grafit mbi letër, ka një trajtim të lirë dhe ekspresiv, më afër portretit të momentit sesa kompozimit akademik. Me pak goditje të sakta, Kuqali arrin të japë jo vetëm tiparet fizike, por edhe karakterin.

*\*Pjesë e projektit UET-UETPress për artet figurative*



SUPLEMENT  
PËR MEDIAN

# INDEXMEDIA

**ALBA ALISHANI**

Moderatorja që nuk bën  
kompromis me profesionin!

**“L’ABANESE D’ITALIA”**

Gazeta e parë shqiptare që zgjoi  
çështjen kombëtare për liri

**JERONIM DE RADA**

Botuesi i parë dhe ‘babai i  
gazetarisë’ shqiptare

## ÇIFTI MEDIATIK

Rudina Xhunga dhe Dritan Hila,  
rrëfimi nga njohja, martesë dhe sukcesi

NGA ARANIT MURAÇI

**R**udina Xhunga dhe Dritan Hila janë ndoshta çifti më i njohur mediatik në Shqipëri. Për të qenë më të saktë, mund të themi se janë çifti më profesional dhe një model sukseesi në tregun mediatik. Pse jo edhe ideal. Ajo me një karrierë për t'u pasur zili në gazetari. Kur e pyesim për median flet me pasionin e një 20-vjeçareje, kurse Dritani flet me siguri dhe e lë modestinë mënjanë kur zbulon njohuritë dhe aftësitë që zotëron.

“Në kërkim të vendit tim në media, vendosa të hap diçka ku punoj vetë dhe mësoj gazetarë të rinj që të gjejnë vendin e tyre në media. Kështu u krijua “Dritare”. E cila më pas, dhe tani që flasim, nuk është thjesht një portal, nuk është thjesht një podcast, por është një televizion online, është një media, është një shtëpi botuese “Dritare”, është një portal “Dritare”, është një televizion online “Dritare”. Dhe ç’është më e rëndësishmja, janë qindra e mijëra ndjekës besnikë të cilët shtohen dhe nuk largohen kurrë. Vijnë për të mos ikur. Le ta quajmë si një dritare e gazetarisë”, thekson Rudina.

### Njohja dhe martesja

Dritani fliste dhe shkruante hapur kundër qeverisë për çështje me interes publik, si ajo e detit e vitit 2009, 21 janari 2011, ndërsa zëri i tij shfaqti interes për Rudinën. Ajo e ftoi në studion e saj “Shqip” dhe kështu nisi njohja mes tyre. “Aty më identifikoi Rudina”, thekson Dritani, - “e cila në atë kohë ishte zëri kryesor i medias. Dhe më ka thirrur dy-tre herë në emision. Është e bukur se në fillim kur po interesohesha për të më ftuar në emision, ajo nuk e identifikonte figurën me emrin... Rudina ndërhyr dhe shton se “nuk e gjeja do kush ishte si njeri dhe më duhet të pyesja” ... “Mendonte se ky ishte diplomat, do jetë ndonjë 60 vjeçar”, ndërhyr Dritani buzëgaz. Kështu nisi njohja, dhe pa u zgatur, edhe pëlqimi. Njohja mes tyre nuk zgjati shumë. - “U njohëm shumë shpejt. U martuam bëmë fëmijë. Punuam bashkë”, - zbulon Rudina. Dritani zbulon detaje të

# ÇIFTI MEDIATIK, RUDINA XHUNGA DHE DRITAN HILA, RRËFIMI NGA NJOHJA, MARTESA DHE SUKSESI



tjera nga njohja mes tyre. - “E kam prezantuar për herë të parë për ditëlindjen time në shtëpi. Që nga ajo kohë kishim 16 ditë që njiheshim. Ditëlindja ime ishte një farë mënyre edhe... edhe... ndërhyr Rudina, “pasaporta për të vazhduar. “Pasaporta për të vazhduar. Vazhduam dhe pastaj jetuam bashkë, jetuam bashkë.” Martesa ndodhi po aq shpejt. “U martuam menjëherë. Më 14 tetor 2011, një ditë shiu me gjyma, u celebruam te Njësia 5, pasi Geraldina e bëri arë sallë të shkëlqejë. Dita e bukur për ne dhe të ftuarit në ceremoninë ku u veshu nuse”, kujton Rudina ditën e dasmës. Dritan Hila kujton edhe numrin e intervistave para dhe pas martesë. Ai thotë se ka shkuar katër herë në intervistë me Rudinën, në studion e saj. “Tre herë përpara dhe njëherë... pas martesë.”

### Ngritja e një media

Dritan Hila tregon më tej emocionet e një gazetari. “Kur hapëm emisionin e parë

dhe pamë që na ndoqën dhjetë shikues, i numëronim një e nga një. U bënë dhjetë që po na ndiqnin online. Edhe unë i thosha “uau, kapëm njëmbëdhjetë”. Pastaj më tej, Rudina kapi 100 shikues. Edhe unë që bërtisja: Po të shohin 100 veta”. “Unë bëj pak politikë. Të jem e singertë. Jam tërhequr nga politika”, shprehet Rudina. “Sepse nuk më sfidon më politika. Ndërsa Dritani vazhdon të trajtojë tematika për politikën. Unë i kushtoj më tepër vëmendje turizmit. Tani jam në fazën e dokumentarëve. Vazhdoj me intervistat online, të cilat janë kryesisht me të panjohur. Doja të realizoja atë që më mungonte. Nuk kisha ftuar të panjohurit. Njerëzit që kanë jetë. Dhe ata kryesisht janë jashtë. Kanë bërë diçka në jetën e tyre dhe doja t’i gjeja. Dhe ia dolëm”.

### Çelësi i suksesit

Ajo mban një televizion të vogël në studio dhe thotë se mban “për të kujtuar se sa e vogël është ajo botë tashmë dhe të cilës unë nuk i përkas më. Dhe i përkas një bote tjetër që është shumë e madhe, është ndërkombëtare, është e të gjithëve, është Youtube-i. Youtube-i është bota e sotme”. Projektin i tyre mediatik lindi në 2014-ën, kur krijuan portalin “Dritare”. Nuk është e vështirë për ta kujtuar vitin. “Një vit mbasi kemi lindur vajzën”, thotë Rudina. “Pastaj më vonë ne kishim qejf të bënim një model perëndimor siç është New York Times, Corriere della Sera, që është portal, ka dhe televizion online. Që merr intervista, reportazhe, dokumentarë e tjerë. Ne besoj ja kemi dalë në Shqipëri. Ne jemi realisht

televizioni i parë online. Tani janë duke krijuar të gjithë, janë zhytur në këtë modën e podcasteve, që është më e thjeshtë sepse kërkon vetëm pak kohë, ndërsa ne kemi bërë një vend ku shumë të tjerë janë të ftuar të bëjnë podcastet e tyre”. Çelësi i suksesit qëndron te fakti sepse “s’kemi bërë kompromis”, thotë Rudina. “Nuk kishim nevojë t’i mburreshim as kujt. Ne donim të tregojmë vetes tonë nëse ja dalim”. Dritan Hila me krenari shton se “jemi i vetmi portal, i modelit perëndimor që është portali dhe televizioni bashkëngjitur në të njëjtën faqe; ti gjen portalin dhe televizionin. Gjen shkrime, lajme, gjen edhe reportazhe, dokumentarë, intervista, podcaste, gjithçka. S’ke asnjë tjetër në Shqipëri”.

**Një shembull sesi media refuzon klikimet e çastit dhe vihet në shërbim të publikut**

Por çfarë do të thotë të jesh markë në treg, të kesh emër të mirë. “Unë s’kam dëgjuar ndonjëri që ta ftonte Rudina dhe mos t’i vinte”, thotë Dritan Hila. Ai beson se prej tyre është ngritur kanali më i mundshëm elitar online, që mund të jetë, “sepse nuk na ka joshur asnjëherë thirrja e gjithfarë psikopatëve që për momentin mund të bëjnë klikime apo të ulin nivelin. Duke përdorur një filtër, si dikur e bënin redaksitë në televizion, Dritani dhe Rudina me njohuritë dhe eksperiencën kanë vendosur tashmë një standard në media. Profesionalizmi është ana tjetër. ‘Rudina ka bërë disa fushata të jashtëzakonshme që kanë ndryshuar trendin e gjërave. Për shembull TAP-i, i cili na shfaqej si një fitore e madhe e Shqipërisë, me qeverinë e dytë. Në fakt Rudina zbuloi që neve nuk fitojmë asnjë gjë nga ajo, kemi fituar vetëm, s’kemi fituar asnjë gjë. Ne fitojmë zero shqiptarë. 100 milion euro që duhet të fitonim taksë kalimi në vit për të fituar, i zbuloi Rudina”, - thekson Dritani.

Rudina po ashtu bëri një fushatë të jashtëzakonshme me gjuhëtarë kundër dalldisë se të gjithë gjuhët e botës vijnë nga shqipja. “Që ishte çmenduri e vërtetë”, shton ai. – ‘Rudina, ftoi këtu gjuhëtarët më të mirë dhe ata frenuan këtë trend, po



them dy iniciativa të mëdha. Kemi bërë fushatë për naftën. Treguam se si është shkatërruar një industri, e cila sot mund të ishte shumë fitimprurëse në ekonomi... Janë bërë disa fushata dhe ne kemi nxjerrë disa personazhe, kryesisht Rudina.”

**Rudina dhe e Dritani, një jetë në media... tashmë jetojnë me median**

Karriera e Rudina Xhungës në media është më e njohur për publikun. Ajo thotë se e ka nisur si gazetare e jashtme te Zëri i Rinisë, ku ka shkruar për herë të parë. “Studimet e mia janë për gjuhë të huaja, për letërsi italiane. Puna e parë serioze dhe e vërtetë është Aleanca Demokratike, gazeta e kulturës tek AD, një gazetë partiake. Dhe menjëherë më pas, Koha Jonë. Ajo ishte gazeta që më bëri gazetare”. Dhe pastaj RTSH. “Aty fillova karrierën në televizion. Që s’mbaroi asnjëherë, sepse e tillë ishte. Fillova si drejtuese dhe autore e emisionit politik në dritare... quhej “Dritare” dhe më pas në Top Channel, drejtuese e emisionit politik kryesor”. Dritan Hila thotë i kujton fillesat e tij në gazetari, si çështje pasioni për të shkruar. “Kisha qejf

të shkruaja. Më pëlqente analiza politike. Isha diplomat në profesion. Dhe duke qenë pjesë e saj kam kundërshtuar marrëveshjen për detin dhe çështje të tjera në shtypin shqiptar. Aty u identifikova që shkruaja”. “Pastaj në 2011-ën ndodhi 21 Janari. Isha i identifikuar si një zë që flisja kundër qeverisë në atë kohë”, thotë Dritani çka fitoi edhe më shumë reputacion dhe mori vlerësime.

Dritan Hila e nisi profesionin e gazetarit krejt papritur. Ai ka drejtuar emisionin “Arena” te Ora News, si moderator. “Te Arena më thirri Ylli Ndroqi. Donte të më jepte një emision. S’kisha ndonjë eksperiencë si moderator. E mora dhe besova se do të ndërtoja një profil tjetër, i cili ngjan në fakt në profilin e Rudinës ku nuk kërkohet sherri, dyluftimi e të tjera”. Dy moderatorë, burrë e grua, në garë me njëri-tjetrin në media të ndryshme, sot kanë median e tyre. A ka përplasje, garë dhe inate, në një raport të tillë. Dritan Hila ndërhyr dhe thotë, “s’jam asnjëherë xheloz për sukseset e Rudinës”. Sepse është e thjeshtë, sukcesi i saj është sukcesi i tij.

# ALBA ALISHANI

## Moderatorja që nuk bën kompromis me profesionin!

INTERVISTA me Alba Alishanin, "Rishikimi i ligjit për mediat në Shqipëri, shans për përmirësim!"

**A**lba Alishani është shndërruar në pak vite në një ikonë të moderimit. "Trialog" është emisioni i saj më i ri në RTSH. Kalimi nga një ekran në një tjetër, mjedisi ku gazetarët ushtrojnë profesionin, janë të zakonshëm për gazetarët në Shqipëri. Por jo vetëm. Edhe pse ka pak kohë që ka nisur një eksperiencë tjetër, për gazetarë që nuk bëjnë kompromis me profesionin, si Alba Alishani, mund të mjaftojë qoftë edhe një emision. Për të lënë gjurmë. Për ta nisur mbarë. Për të tërhequr vërejtjen e publikut, për të përcjellë mesazhin që duhet. I tillë është misioni i gazetarisë. Pasioni dhe profesionalizmi janë pjesë e pandarë e Alba Alishanit, virtyte të cilat ajo di t'i përcjellë si në mjedisin mediatik, me kolegët dhe jo vetëm, ashtu edhe përballë me audiencën. Është politika që ndikon më shumë se çdo gjë tjetër në jetën e njerëzve të thjeshtë dhe media është ajo që e përçon mesazhin e saj, prandaj edhe ka një përgjegjësi që nuk duhet nënvlerësuar në jetën e përditshme dhe progresin shoqëror. Për këtë arsye Alba Alishani u bë pjesë e MAPO, në suplementin INDEXMEDIA, për të prekur disa nga çështjet dhe problematikat e mediave sot në vendin tonë, mbi rëndësinë që ka media për të përcjellë siç duhet mesazhin në publik. E kush tjetër mund të japë një më të vlefshëm se gazetarë që nuk bëjnë kompromis me profesionin, si Alba Alishani:

### 1. Nisur nga eksperiencia juaj, si ka ndryshuar gazetaria në epokën e mediave sociale?

Në peshoren mes avantazheve për t'u vlerësuar e shfrytëzuar, lehtësirave në përdorim dhe keqpërdorimit të aseteve që ke në duar, rëndom prevalon për qenien njerëzore, kjo e fundit! Njësoj siç gjykoj të ketë ndodhur, me të bërit gazetar në epokën më pak sociale, të mediave sociale. Të jesh një klik butoni, larg aksesit për një bollëk informacioni, herë të vlefshme e herë jo, me nevojën për të verifikuar e klasifikuar, në finale, ka çuar drejt një fushe magnetike, me pak kreativitet, shumë ujëra, pak esencë, shterpësi mendimi e shpesh edhe diskutim vërtetësie! Madje, vlerësoj se të bërit gazetar në epokën e mediave sociale, i është mbivendosur konceptit dhe ka keqpërdorim të profilit. Sot, hapësira e rrjeteve sociale, i ka dhënë fuqinë dhe mundësinë e të vetëshpallurit, shumë profileve anonime dhe jo, që besojnë se janë të thirrur në misionin e të bërit gazetar! Fuqia e një mjeti smart në duart e secilit është dhe dobësia e kësaj fushe sot, që përballlet me risqe e përbaltje shpesh! Të mendosh se di, mundesh dhe duhesh, nuk është çertifikimi final që JE!

**2. Beteja ndaj "Fake News" është bërë më e ashpër gjatë dekadës së fundit apo mendoni se ka ndodhur e kundërta; është krijuar një hapësirë për të vër-**

### tetën e munguar në mediat tradicionale si Gazeta, TV, Radio etj?

Si për vijimësi logjike...edhe pyetja juaj e dytë, është linja e mendimit tim, që vijon nga e para. Rrjedhimisht, beteja ndaj "fakeut", lajmit të pavërtetë, që ndodh të jetë informacioni i rremë dhe i paverifikuar në rastin, lehtësisht me të pranueshëm por edhe abuzim e përdorim, në funksion të pavërtetësisë, në rastin më të keq, progresivisht është më e ashpër, më intensive dhe më vështirë e luftueshme!

### Pse?

Nuk ka pasur hapësirë të munguar! Kanë ekzistuar disa filtra funksionalë me shumë, kategorizim, rigorozitet në saktësi, verifikim, botim... E ajo që quhet "hapësirë për të vërtetën" sot, ndodh shpesh, që të shndërrohet në hapësirë për abuzim me informacionin ose hapësirë dezinformative!

### 3. Si do ta krahasonit nivelin e tregut mediatik në Shqipëri e Kosovë me atë në rajon dhe më gjerë. Mendoni se është një dështim apo sukses?

Do të dëshiroja seriozisht që të flisnim seriozisht për "Treg Mediatik rajoni! Por druhem se shifrat dhe komportimi i tyre me realitetin ku kontribuojmë e jetojmë, na ftojnë ta orientojmë bisedën drejt një Tregu Biznesi, ku media (e çdo kategorizimi) është mjeti mediator, që asiston në realizimin e qëllimeve të biznesit fitimpru-



rës, të cilit i prin politika dhe i ndihmon kjo e fundit! Siç edhe Balzak për kohëzgjatë të çuditshme epokash shkruante: “Gazeta, në vend që të jetë një mjet për t’i shërbyer shoqërisë, është bërë një armë në du-

art e partive, arma është kthyer në tregti dhe si të gjitha tregtitë nuk njeh as ligj, as fe.”

Matje e matje të sakta për më tepër ka pak dhe ne vuajmë nga mungesa e referi-

meve kokëforta, që janë statistikave. Megjithatë, matje të viteve të fundit flasin për më shumë se 800 “kanale informative”, mbi 20% e të cilave tradicionale që veprojnë në terrenin e tregut mediatik në Shqipëri! Rastet e rajonit nuk ndryshojnë drastikisht, si realitete me të “vepruarit mediatik” në Shqipëri! Po të analizosh shifrat dhe kontekstin ku këto kanale operojnë, modeli i të bërit biznes është kryefjalë por modelin nuk e justifikojnë të ardhurat e gjeneruara!

Pra, mjete në disproporcion me realizimin e qëllimeve! Pjesa dërrmuese e tyre, statistikisht, ose i mbulojnë vet shpenzimet, ose janë biznese që dalin me humbje! Atëherë si dhe pse kaq shumë?!!

**4. A ka nevojë të rishikohet ligji për të mbrojtur gazetarinë që krijon, ideon, prodhon, me qëllim për të vlerësuar, shpërblyer dhe inkurajuar aftësitë krijuese?**

Rishikimi është shans për përmirësim! Ribërja me seriozitet do të ishte mundësi për korrigjim, nëse janë vullnetet!

**5. Nëse do të ishte në dorën tuaj të ndryshonit diçka, çfarë do të ndryshonit tregut mediatik në Shqipëri?**

Në rreshtat e kësaj interviste është nënkuptuar mjaftueshëm për atë se çfarë do të duhej të ndryshonte, ose të ndërhyhej për përmirësim! Shqetësues është monitorimi i munguar dhe të funksionarit jashtë kompetencave të ligjit dhe autoritetit (në këtë rast AMA-s) e një pjese dërrmuese e kanaleve që shërbejnë për të “informuar” sot, që është media jo tradicionale dhe që në fakt, e ka “ngulfatur” tregun me bollëk si numër dhe me “misione” si detyra!

Palët e paineduara, fatkeqësisht edhe në konflikt interesi janë palët, vullneti i të cilave është vendim-marrës në këtë drejtim! Varfëria, në kuptimin klasik dhe të mirëfilltë të këtij nocioni, është peng-marrja e sigurt e profesionistëve, që sot janë kokëulur me dinjitetin e rrëmbyer dhe të nënshtruar për t’u bindur dhe jo për të shërbyer si të thirrur në këtë mision!

# “L’ABANESE D’ITALIA”

## Gazeta e parë shqiptare që zgjoi çështjen kombëtare për liri

Më 23 shkurt 1848 u themelua gazeta e parë shqip, në vendin fqinj

“L’Abanese d’Italia” është gazeta e parë shqiptare, e cila u krijua për të informuar opinionin publik të komunitetit Arbëresh në Itali. Është ngjarje historike si organi i parë mediatik për shqiptarët, ndonëse si media u themelua dhe u krijua në një kohë kur nuk ishte unifikuar alfabeti i gjuhës shqipe. Ishte koha e zgjimit të Rilindjes sonë Kombëtare. Për më tepër se pesë shekuj, Shqipëria ishte nën pushtimin osman. Kur doli në shtyp gazeta e parë shqiptare, edhe shkollat në gjuhën shqipe ishin të ndaluara në territoret shqiptare. Kjo krijoi mundësi në komunitet të gjerë shqiptarësh në Itali lindi mbi dy shekuj më parë ideja brilante e gjenit të letrave, Jorenim de Rada (1814-1903), i konsideruar gjerësisht si ‘babai i gazetarisë’ shqiptare.

Më 23 shkurt 1848, në Napoli u botua gazeta e parë shqipe, me emrin “L’Albanese d’Italia”, ajo që njihet gjerësisht si media e parë për shqiptarët, kudo në botë. Gazeta u ideua, u redaktua dhe u drejtua nga intelektuali dhe shkrimtari i madh arbëresh Jorenim De Rada. Vetë De Rada ishte përgjegjës jo vetëm për botimet, por edhe për shumicën e artikujve, korrigjimet dhe të gjitha proceset editoriale në redaksi, financimin dhe deri në publikimin e gazetës.

E botuar kryesisht në italisht dhe pjesërisht në arbërisht, gazeta u krijua fillimisht për të shërbyer si një forum për të përçuar mesazhe politike, shoqërore dhe kulturore. Gazeta kur është prezantuar për publikun në një nga panairët e përvitshme të librit që janë mbajtur gjatë viteve të fundit në Tiranë, nga profesorët italianë Matteo Mandala dhe Francesko Altimari në st-

edën e Institutit italian të kulturës, u vlerësua si e tillë: “L’Abanese d’Italia” është gazeta e parë shqiptare.

Ajo pati ndikim të menjëhershëm, megjithëse një tjetër gazetë më pak e njohur dhe me një ide të ngjashme është themeluar në vitin 1839 në Palermo nga një tjetër arbëresh që quhej Francesko Crispi.

Gjithsesi “L’Abanese d’Italia” pati impakt dhe u bë e njohur gjerësisht mes shqiptarëve, jo vetëm arbëreshëve të Italisë. Temat kryesore që janë botuar në gazetën e parë shqiptare kishin në fokus politikën, ekonominë por edhe artikuj që trajtonin çështjen kombëtare dhe rëndësinë për liri dhe pavarësi. Gazeta e parë shqiptare ka ndjekur rrjedhën e lëvizjes revolucionare në Napoli nga muaji shkurt deri në qershor të vitit 1848. Si i ri, i nxitur nga lëvizja e re kulturore romantike, De Rada filloi të rribulonte identitetin e tij shqiptar duke mbledhur folklorin e pasur e të pranishëm në Arbëri (bashkësitë arbëreshe) të Italisë.

Në fillimet e veta De Rada dikur ndihej i pavendosur për të zgjedhur midis matematikës dhe letërsisë. Ai studioi për juridik por talenti i tij ishte diku tjetër. Janë gjetur shënime në fletoret e tij të mbushura me figura gjeometrike dhe formula matematikore. Studiuesit kanë zbuluar aftësitë e tij të tilla sa mund të mësonte përmendësh rrënjën katrore të një numri me njëzet e katër shifra, e cila, nëse shkruhet, arrin në disa miliarda, rast që mund të mos jetë unik në botë, por mbetet jashtëzakonisht i rrallë. Mes kontradiktave, De Rada vendosi të çojë para pasionin e tij, duke shkru-

ar dhe botuar artikuj historikë, poema dhe novela romantike.

De Rada shkroi fillimisht në gjuhën italiane. Më pas në arbërisht. Nga dy mediat periodike të redaktuar e të botuar prej De Radës, “L’Albanese d’Italia” është më tepër në italisht, kurse “Flamuri i Arbërit” është në të dyja gjuhët. Shumë nga dorëshkrimet dhe publikimet e De Radës fatkeqësisht kanë humbur.

“Para se Shqipëria të bëhej një entitet politik, ajo ishte tashmë një realitet poetik në veprat e Girolamo De Radës. Vizioni i tij për një Shqipëri të pavarur u rrit në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë nga një dëshirë e thjeshtë në një objektiv politik realist, të cilit ai iu përkushtua me pasion”, thotë Robert Elsie, një ekspert në studimet albanologjike.

Në fillim të viteve 1990, që përkon me fluksin e emigrantëve shqiptarë nga Shqipëria në Itali, Roland Sejko themeloi “L’albanese d’Italia” (Shqiptari i Italisë) si një gazetë të re dygjuhëshe italisht-shqip, me seli në Romë.

Përmes gazetës së parë për shqiptarët arbereshë por edhe më gjerë, në diasporë, shkrimtari, publicisti, dhe gazetari Jorenim De Rada përmes zërit të tij zgjoi Rilindjen Kombëtare dhe zhvillimet e mëtejshme të kombit shqiptar për liri e pavarësi. Lidhja e Prizrenit, Kongresi i Manastirit, deri te Pavarësia e Shqipërisë. Hapi i tij i parë nxiti dhe u pasua në hapjen e gazetave të tjera nga patriotët shqiptarë nëpër botë, në një kohë kur zgjimi i çështjes kombëtare ishte aq i jetik për mbijetesën e kombit shqiptar.

# L'ALBANESE D'ITALIA

## Giornale Politico Morale Letterario.

### ASSOCIAZIONE

Tre Mesi . . . . . gr. 3  
 Sei Mesi . . . . . gr. 6  
 Un Anno . . . . . gr. 12  
 Un foglio . . . . . gr. 1

### IL PREZZO

DELL' ASSOCIAZIONE SI PAGA ANTICIPATO.

### UFFIZIO

TAVOLA DE' SPAGNOLI N. 31 2.° PIANO A DESTRA.

La Posta per le provincie e per l'estero è a carico degli associati; né si ricevono lettere o articoli, se non affrancati.

### Distribuzione Mercoledì e Sabato.

### PROGRAMMA.

Una sola e medesima gente abitò in antico l'Italia e l' settentrione della Grecia; gente augusta e severa, e in quel tempo ricordevole della primitiva verità. Essa disparve poi dall'Italia, sotto l'affluire perenne di popoli che dalle quattro regioni della terra hanno sempre ambito fruire le aure, che dà più grate alla vita questo clima sereno: E di essa rimase soltanto la divina mente e virtù, che vittoriosa del pensare e dei costumi de' nuovi venuti, si levò come un albero di fatati rami, ed occupò con Roma la terra. Ma di là su l'altra banda dell'Adriatico era tuttavia superstita l'antica stirpe; e non meno grande ne' divisamenti e nelle azioni avea del pari pensato due volte, con Isparta e con Alessandro, al dominio del mondo. Quindi un sentimento di antica fraternità e comune fede univa all'Epiro l'Esperia: Noi, diceva Elleno nell'Eneide,

« delle due genti un tempo cognate, de' due » popoli vicini, l'Esperia e l'Epiro, faremo » una città sola e d'animi unita ».

Queste sono le memorie dell' antichità. I tempi nuovi hanno al declinare del Medio Evo, visto le due genti propinque e già sì gloriose, far argine del loro coraggio unito esse sole contra la piena degli Ottomani: e come una di esse, l'eroica Albania, ebbe soccombuto, veduto hanno l'altra accorrere in immenso numero nelle sue città e campagne, i figli della vinta e onorarli riguardosa, come si conveniva a prodi caduti per magnanima causa.

La Chiesa allora afflitta dallo scandalo della vittoria della Mezzalana su la Croce, e quindi lacerata senza rispetto da' dissidi de' suoi figli, sofferse essa pure con gli esuli padri nostri, e con l'Italia tutta in cui erano ospitati e a cui poco riparo erano omai le dottrine cristiane, contro alle voglie inique de' tiranni e delle fazioni. Ella ne coperse del suo bianco manto, e aspettavamo

insieme il giorno consolatore del quale potremmo dire: « Questo è il dì che ha fatto » il Signore, rallegriamoci ed esultiamo in » esso ».

E questo dì è già fatto per l'Italia. Iddio ha rimessa di sua mano nel trono questa sua fida, e dato le ha, fra le altre, un pensiero di fiducia grave nel bene eterno della virtù. Noi partecipiamo alla sua libertà come già ad ogni altro suo bene; e ci alleghiamo dal profondo del cuore in veder sorgere con essa la rimembranza dell'avito sentimento riguardo alla vita, nel quale l'uomo era d'assai preferito all'esterne fortune, e una frugale semplicità educatrice di Eroi alla rilassata corporale comodità dell'Asia barbara. Ristretti dunque vieppiù ad essa da tanta grazia di cielo ch'empie oggi noi anche di bella speme su la sorte d'Albania, e poi dal ridestato amore dell'alto vivere italo-greco, prenderemo del libero campo aperto, con animi convenienti a figliuoli di martiri e riedificando, se ne

### FRULLETON.

#### VALE GAREIS MADRE.

1. Mür se vién to na gelvshòsh  
 Dishorisme Lhésterii!  
 Mür se vién l' ti rosh e shòsh  
 Me to lhavossuric gnerii!  
 Mür se vien to trish me nec  
 Forsa gkilla rrii mb' Dhee,  
 Por sà dèci shogh ree.  
 2. Ti na stréxe porsi bic  
 U ndo dhee e' i thàtur etti,  
 Daalla e dàllh eaur kiul u shie  
 Cui e dèsh e nanch e gkietti.  
 Ti na vien si màlve hòra,  
 Si shòndetta, còi psora  
 M' i l' hichsiti gkith vetgheen.  
 3. Mèlin e' von gareish e mbìona,  
 Porsi i dshimi to reen  
 Nosse l' hainour eaur e cion  
 Buccenish si nò e gkicea  
 Sit e tij to paren gheer;  
 Treentalhe ndo paraveer,  
 Drit e' nzier gkìt errasir.  
 4. Na si gerùaja e' to piecl  
 Rrii ngeà tred, e tas daròna  
 Ketu to dh' embert, eaur to siecl  
 Birin prà mbo cragh, gelvshòn:  
 Ott: Baccor atto d' hromhinme!  
 Ott: P' d' shura valhinme  
 Keon alla e' mo mbian!

#### LA RIDDA (\*) DELLA GRANDE FESTA.

Sii tu ben venuta ad allegarci o desiata Libertà! sii la ben venuta! Che tu viva, e adegui collegando fra sè i giorni della stanca umanità! Sii ben venuta a dimorarti con noi, finchè la vita starà in terra, fino a che il mare veda sopra sè passar nubi.  
 Tu ci sei comparsa come scende acqua piovana in terra arida da sete, allora quando lenta lenta il cielo la riversa a lei cioè ne ardeva e non potè averla. Tu ne giungi come a' monti la neve, come la sanità ad uomo di cui ha la fortuna emunto tutto l' essere.  
 I nostri desiri tu compì di gaudio alla guisa che l'amato satifa a sposa che novella rimasta sia in di lui casa per lunghi dì, quando e' poi riede e la ritrova bella come più gli parve agli occhi la prima volta, rosa nella primavera, luce che disipa ogni oscura memoria.  
 Simile questo bel paese a donna ch'è d' ora in ora per partorire, e già soffre tacita sue doglie, e poi va tutta giuliva, quando si porta l' figlio in braccio, e dice in cor suo: « Dolori avventurosi, e carì pianti che furon quelli, ch' em- » pivano i miei dì! »

5. O gareis! erdhe! me tij  
 Sòle to dashuren ampni!  
 E ajo e' as dòt to na vij  
 Rrii me nec, b' gatorii!  
 Jemmi voléshor, jemmi motra,  
 Jemmi zhògna, jemmi zhotra  
 Shipi-vo-bapta gkith-garee.  
 6. Bhrin j'oma mond shòrngecong  
 Buach-késhene e ashà si daardh,  
 Caur gèrène to bastoog  
 Skeep e cik po edhé to baardh:  
 Se pà ishtra voléshor jemmi,  
 E dolhir me nec chemmi  
 Madh-miccin e' sòle vett.  
 7. Erdhe, e curmin nonch e chee  
 Pìott l' havomma, si m' e ean  
 Motrat unde e' si ree  
 Gkicendòre shòvàn e vaan:  
 Ti n' s' s'òvòve goathulòre  
 Si lunàrdha eaur ampòre  
 Sial ndo dèit dèghev ulii.  
 8. Ti na erdhe si fiamira  
 Gheer, e' shèezh ndo zhòmer gliin;  
 Ti n' arrovòve si dollira  
 Fatte, e' s'ott mb' dhee gadhiin;  
 Na u shulhòve e' rec el-shilli  
 Porsi j'om e' zorròbilht  
 Shégh praà cho par mott s' i paa.  
 9. Sà dariam ti bon to gòrvògnom  
 E sà pattoim gheer to zhécha,  
 Me nd' hès mottin to mbiògnom:  
 Dìt to shéla, e' natt to dhécha  
 He-mb' dhas e' risheh-llhikime  
 Bon to shéghmi: e' bashch me nec  
 Rrii par ssa to jeet dhee!

O gioia! e dunque venisti? Con te portato hai la desiata pace! E quella che non pareva più venire, sta or con noi felice ricchezza! Siamo fratelli, siamo sorelle, siamo signori, siamo signore, e le nostre case aperte in pace e con festa.  
 Può or suoi figli stringer la madre, rideute il labbro, e soave come mela, alteramente adorna del velo a fasce vermiglie e bianche: perchè senza guerra, siam fratelli d' amore, e schietta e candida abbiam con noi la Fede benefica che tu hai portata.  
 Venuta sei, e non hai la persona guasta da ferite come la ebbero le altre tue sorelle, che come una nube sanguinosa passarono e andarono. Tu a noi arrivasti piena d' esultanza, come la colomba placida che portò l'ulivo su le acque che avean per lidi l'orizzonte.  
 Tu ne venisti, come l' ora felice che lieve e placida entra nell' animo; come una fata serena che annunzia il bene al mondo. A noi ti sei mostrata nuova di pensiero e di amore, pari a madre che rivede i suoi piccioli figli, dopo che non li vide da una settimana.  
 Quanto soffrimmo, fa tu che l'abbliam noi, e quanti avemmo tristi giorni: sicchè coluiamo il tempo passato col perdono. Fa che vediamo giorni limpidi, e notti accese di grandi stelle fulgenti: e in compagnia nostra resta, finchè resta la terra!

Podere Antonio Santori.

(\*) Il coro, stato fondamento alla tragedia di Tespi, dura con la fisonomia primitiva, nelle Ridda Albanesi. In ogni pubblica gioia, tutte le cittadine affiancate da' consanguinei e vestite a festa, scendendo in istrada, si prendon per mano, e intessuta la ridda ch' essi dicon Vala, spiegano un canto accompagnato con la misura de' passi.



## 100 PORTRETE GAZETARËSH\*

### Jeronim De Rada, botuesi i parë dhe 'babai i gazetarisë' shqiptare

Jeronim De Rada (29 Nëntor 1814 – 28 Shkurt 1903), i njohur gjerësisht si “babai i gazetarisë” shqiptare, themeloi dhe ngriti i pari gazetën shqiptare, “L’albanese d’Italia”. Iu përkushtua çështjes kombëtare, që çoi në zgjimin e Rilindjes sonë Kombëtare. I talentuar në matematikë dhe pse u arsimua për drejtësi, spikati në letërsi dhe publicistikë. Në vitin 1836, De Rada kur nxori botimin e parë të poemës së tij më të njohur në gjuhën shqipe, “Këngët e Milosaos”, u detyrua të braktiste studimet për shkak të një epidemie. De Rada shërbeu si gazetar dhe redaktor i parë edhe si financues. E para media shqiptare në histori e themeluar më 23 shkurt 1948 në Itali vazhdoi misionin fisnik të ruajtjes së gjuhës dhe kulturës shqipe në vendin fqinj, falë një mendje gjeniale që mbante emrin, Jeronim De Rada.

*\*Pjesë e projektit UET-UETPress për historinë e medias*



# M IMAGO

SUPLEMENT  
PËR ARTET  
PAMORE

**DAVID MEÇANI**

Piktori dhe ixhinieri  
atipik i kryeqytetit

**“DASMA SHKODRANE”**

Thesari i Kol Idromenos që  
tregon gjithçka në një kuadrat

**100 FIGURA HISTORIKE  
NË PIKTURËN SHQIPTARE**

Skënderbeu, heroi kombëtar në  
pikturën shqiptare dhe  
evropiane

## **TEODOR DHOSKA DHE SEKRETET E NJË KOLEKSIONISTI NË SHQIPËRI**

**DAVID MEÇANI/** Piktori dhe ixhinieri atipik i kryeqytetit  
**ÇATIN SARAÇI/** Intelektuali që braktisi diplomacinë për pikturën

NGA LUIZA PINDERI

**K**a një histori interesante për Pablo Picasso-n, artistin më me ndikim të gjysmës së parë të shekullit XX-të. Edhe pse duket e pabesueshme për një autoritet të tillë në pikturë, spanjulli pati ndikim të fuqishëm nga piktori francez autodidakt Henri Rousseau, i quajtur doganieri për shkak se punoi pjesën më të madhe të jetës si oficer në portat e stacioneve të lumenjve të Parisit.

Picasso e takoi punën e Rousseau-n në një dyqan vjeturinash në Paris. "Portreti i një gruaje" quhej piktura të cilën e bleu për pesë franga dhe e mbajti me fanatizëm gjithë jetën, aq sa edhe sot është pjesë e koleksionit Musée Picasso në Paris. Për nder të tij, Picasso organizoi një banket të famshëm në 1908-ën me figurat më të njohura të asaj kohe në kryeqytetin francez, që i hapi derën e botës së artit artistit të panjohur.

Stili naiv dhe kapërcimi imagjinar ishin arsye pse piktori spanjoll admironte punën e doganierit, duke u ndikuar jo pak në veprat që prodhoi. Kritiku britanik i artit, Jonathan Jones, shkoi aq larg në një artikull të 2005-ës në "The Guardian" me titull "Kur Henri takoi Pablun", sa thotë: "Picasso nuk do ta kishte pikturuar kurrë Guernicën pa atë të pafajshmin e të butin, Henri Rousseau".

Kurrë nuk mund ta dish se çfarë mund të influencojë në jetë. Një moment, një fjalë, një ngjarje, një takim mund të bëhet shkak i shumë ndryshimeve të buta apo rrënjësore. Dëshmitë për këtë nuk mungojnë.

Ndoshta as Teodor Dhoska nuk do të ishte bërë koleksionist i njohur dhe me ndikim në rrethin e kulturës shqiptare, nëse nuk do të kishte punuar në vitet '80-të në Shtëpinë Botuese të Librit Shkollor. I rrethuar nga piktorë që bënin ilustrimet e librave shkollorë, bisedat për artin dhe pikturën do të ishin të gjata e dobiprurëse për një inxhinier radio-elektronik që prodhonte mjetet didaktike të laboratorëve. Do të ishte ky ambient e ky rreth social që do të zgjonte pasionin për artin dhe do i diktonte një rrugëtim gradual në këtë fushë: nga admirues në koleksionist e më vonë në shkallën më të lartë, atë të galeristit. Miqësia e ngushtë me piktorin Buron Kaceli dhe piktorë të tjerë si Lumturi Blloshmi, Remzi Kuçi e Lec Shkreli do e familjarizojnë aq shumë me pikturën dhe skulpturën sa nuk do iu ndahet për dekada të tëra. Vitet 2000-jë e bënë më intensive këtë mar-

## TEODOR DHOSKA DHE SEKRETET E NJË KOLEKSIONISTI NË SHQIPËRI

Gjurmimi, qëmtimi i hollësishëm dhe ruajtja e vlerave kulturore nuk është një biznes i zakonshëm për Teodor Dhoskën. Është një pasion i pashtershëm që hodhi rrënjë dekada më parë dhe u shndërrua ndër vite në një mënyrë jetese.



rëdhënie me artin, kur ai filloi të blejë dhe koleksionojë pikturat dhe skulpturat e para. "Që të koleksionosh duhet të plotësosh dy kriteret. Duhet mundësi financiare, por para kësaj duhet pasion dhe prirje," thotë z. Dhoska. S'ka asnjë ndrojtje për të pranuar se nuk di të pikturojë. Nuk ka pse! "Koleksionistët nuk janë piktorë", shton më tej. Pavarësisht

se formimin akademik e ka në shkencat teknike, gjithmonë ka qenë i tërhequr nga arti dhe filozofia, simbioza e të cilave ndërlihd mendimin me emocionin dhe prek lartësitë e kënaqësisë njerëzore.

"Jam i intriguar nga procesi krijues, se të njëjtin proces krijues ka edhe shkenca. Proces i pashpjegueshëm, dhuratë e lindur."

### Tetë vitet e arta të Didart

Ndenija në rrethet e kulturës gati-gati mund të quhet një shkollë, sa i përket edukimit me historinë e artit dhe pikturës. Ishte një mprehje e shqisave dhe kalitje e aftësisë për të identifikuar më së miri vlerat artistike. Atëherë kur kishte mbledhur një fond të konsiderueshëm pikturash bëri kapërcimin e madh për t'i dhënë tjetër dimension emrit dhe pasionit të tij.

Ishte viti 2004-ër kur hapi galerinë private Didart në rrugën "Islam Alla" në Tiranë. Ekspozita e parë u realizua me skulptorin Perikli Çuli dhe piktorin Gazmend Leka, për të vijuar pastaj me piktorë të tjerë të afirmuar, si: Kujtim Buza, Lec Shkreli, Hasan Nallbani, Ardian Isufi, Vilson Kilica, Ksenofon Dilo apo skulptorët Thoma Thomai, Muntaz Dhrami etj. "Bëja ekspozita me pikturë edhe me skulpturë njëkohësisht. Ishin të gjitha falas", tregon Dhoska. Do të vijojë për një vit kjo praktikë e ekspozimit pa detyrime financiare për artistët. Sa herë sillnin punime të reja hapeshin ekspozita me dy-tre autorë, të cilat zgjasnin gjithashtu nga dy-tre javë. Pikturat e tyre shiteshin brenda galerisë, e në raste të tjera bliheshin nga vetë galeristi.

E ka pasur pjesë të punës dhe të kënaqësisë profesionale shoqërimin me artistët, duke qëndruar me ta gjatë gjithë kohës që zgjaste ekspozita. Do t'i vlente ky kujdes i treguar për të përzgjedhur më tej tre emra piktorësh e për të ekspozuar vetëm krijimtarinë e tyre. Adrian Çene, Shkëlqim Kokonozi dhe Lek Tasi duket se kaluan "provën e zjarrit" për të vijuar një bashkëpunim të pakohë. "Këta të tre i konsideroj si piktorët e mi", thotë z. Dhoska. Shpjegon se ishin disa faktorë që ndikuan në kanonizimin e këtyre artistëve. Përtej bindjes së tij për vlerat artistike që ata mbartin, studioi tregun për të parë se sa të kërkuar ishin me çmimet që ata qaseshin. Ekspozimi në galerinë Didart dhe marketimi i krijimtarisë artistike lindte detyrimin për piktorët, përmes një marrëveshjeje të pashkruara, që të gjitha veprat e tyre të shiteshin vetëm brenda saj. Rregullat e çdo biznesi sigurisht që janë po aq të vlefshme në tregun e artit. Besueshmëria mbetet çelësi i suksesit të çdo shkëmbimi. Edhe për galerinë është thelbësore kredibiliteti, i siguruar nga vendosja e çmimeve që përkojnë me vlerën e një veprë. "Piktura është mjaft subjektive në vlerësim dhe blerësi mund t'i besojë më shumë galerisë, pasi ajo është filter që bën vlerësimin. Nëse galeria nuk e bën këtë, ajo



dështon", shpjegon Dhoska. Ai thotë se nuk mund ta vendosë vlerën financiare të një veprë ai që e prodhon atë. Duhet një strukturë tjetër, kritikë arti, galerist, që shkon përtej subjektivizmit dhe qëllimeve personale të artistit, i cili ka tendencën të rrisë vlerën e krijimtarisë për të rritur famën dhe të ardhurat.

Shtimi i shpenzimeve bëri që shumë galeri private të mos mbijetonin. Sot janë vetëm disa të tilla publike nën administrimin e institucioneve lokale, ndërsa artistët më me emër janë kufizuar te studiot e tyre. Didart ishte



ndër të fundit që u mbyll në 2012-ën. Teodor Dhoska thotë se ajo e përfundoi ciklin, duke qenë hallkë e rëndësishme e ndër lidhjes mes publikut dhe artit. Nëse koleksionisti mbledh vlera të rralla dhe i ruan, galeristi është ai që bën përballjen e veprës të artistit me publikun, me ardashësin. Kështu renditen vlerat, theksohen emrat. Një proces i tillë ndodhi me piktorin Lekë Tasi, rrugëtimi i të cilit ndryshoi kryekëput pas ekspozimit në galeri.

"Unë e kam marrë nga viti 2006-të kur të tjerët e konsideronin pikturën e tij pavlerë. Futja në galeri bëri që t'i rritet vlera", thotë Dhoska. Ekspozimi për 4-5 vite rresht në galeri, dalja në media, ndikuan gjithashtu pozitivisht për t'u bërë i kërkuar nga shqiptarët dhe të huajt. Dimensioi i tij intelektual, jo vetëm si piktor, por edhe si teolog e shkrimtar, e bën jashtëzakonisht të vlerësuar. Pavarësisht se nuk është ekspozuar në galeritë ndërkombëtare, kuotimi i tij është mjaft i mirë.

Dhoska thotë se ekspozimi në galeritë e huaja rrit vlerën e artistit. Por në Shqipëri shumë pak piktorë kanë mundur të kapërcejnë atë derë, siç janë Alush Shima dhe Edi Hila. Janë pastaj edhe artistët të njohur në botë, si Anri Sala e emra të tjerë po aq të suksesshëm, të cilët dallojnë nga fakti se formimi dhe edukimi i tyre është bërë në perëndim.



# DAVID MEÇANI

## Piktori dhe inxhinieri atipik i kryeqytetit

E para ishte piktura, e dyta inxhinieria, e treta mësimdhënia. Janë këto tre ndërmarrjet më të mëdha të jetës së David Meçanit, të ushyera nga pasioni dhe të shpërblyera nga suksesi.

**L**eonardo da Vinçi, Samuel Morse, Gjon Mili, Kelly Heaton, Robert C. Jackson, Billy Klüver... Në pamje të parë duket si një renditje e çoroditur emrash, disa syresh shumë të njohur, e të tjerë më pak ose aspak të dëgjuar. E vërteta është se pavarësisht se janë emra, në dukje pa më të voglën lidhje, që u përkasin periudhave të ndryshme historike, ka një element të fortë identifikues. Të gjithë janë personalitete me formim në shkencat ekzakte që kanë spikatur ose janë bërë të mirënjohur në fushën e artit, në pikturë, fotografi, kinematografi etj. Disa artistë dhe krijues të shquar studiuuan ose punuan në inxhinieri elektrike para ose gjatë karrierës së tyre në art. Samuel Morse, para se të shpikte telegrafin, ishte i njohur për portretet. Gustave Caillebotte u trajnuua si inxhinier përpara se të përfshihej thellësisht në lëvizjen impresioniste dhe të njihej për trajtimin realist në pikturë. Gjon Mili, po ashtu, studioi inxhinieri elektrike në MIT, para se të bëhej i famshëm për eksperimentimet në fotografi. Rowan Atkinson, i njohur për rolin e famshëm Mr. Bean, ndoqi një diplomë masteri në Inxhinieri Elektrike në Kolegjin e Mbretëreshës, Oxford. Mjaft mirë kësaj liste mund t'i bashkëngjitet David Meçani, inxhinier elektrik dhe pikturor, dy kriteret që e bëjnë të papërgjithshëm. Ndoshta jo aq i njohur ndërkombëtarisht, por mjaftueshëm i njohur në rrethin dhe komunitetin e tij, ndërsa moshë dhe eksperiencë premtore shumë në të ardhmen. Sot këto dy pasione dhe profesione ecin paralelisht, por zbulimi ndodhi në faza të ndryshme.

E para ishte piktura. Mes lodrave të shumta duart e tij shtriheshin drejt ngjyrave. Vizatimet e pakuptimta me vitet filluan të përçonin mesazhet dhe identitetin e një piktori në agim. Nga skicat dhe vizatimet me laps kaloi te penelat, bojërat, teknikat mikse dhe së fundi te teknikat e vajit. Ka qenë një udhëtim vetëzbulues, përmes leximit, vëzhgimit dhe njohjes me teknikat e pikturorëve më të njohur. Familja e tij ende nuk e njihte një pikturor, edhe pse arti kishte qenë prezent në forma dhe shprehje të ndryshme përmes arkitekturës apo grafik-dizajnit.

Kur prindërit panë pasionin dhe u bindën për talentin nuk e kursyen mbështetjen, ndërsa vijonte shkollën 9-vjeçare "Emin Duraku" në Tiranë dhe kohën më të madhe ia kushtonte pikturës. Shkolla e mesme do të diktonte pasionin e dytë që sot është puna dhe profesioni i tij. Mes dilemës për të shkuar në Liceun Artistik "Jordan Misja", për shkak të shoqërimit me pikturën dhe gjimnazit të përgjithshëm "Petro Nini Luarasi", vendosi për të dytin. Jo sepse atëherë e dinte që Inxhinieria Elektrike do të ishte programi i studimit në universitet, por ama e kishte kuptuar se prirjet e tij shkonin drejt shkencave

ekzakte, të cilat sot i përdor mjaft mirë në kompozimin e pikturave. Pati vërtet një fazë që bëri kalimin e madh nga një i pasionuar pas pikturës te një profesionist: ishte hapja e studios së tij. “Punoja gjithë kohën edhe pashë një moment se nuk kisha më vend në shtëpi për t’i mbajtur”, shprehet Davidi. Studioja e tij sot mban një fond të konsiderueshëm ku spikasin peizazhet, portretet dhe figurat historike, kompozimet me lule, të shprehura përmes ngjyrave të gjalla dhe të thella, që përcjellin harmoni, energji dhe gëzim. E ndërsa në temat, personazhet dhe karakteret historike, gjen elementë të spikatur, identifikues të ngjarjeve të mëdha që kanë shenjuar historinë e shqiptarëve, krejt ndryshe është metodika e pikturimit të peizazheve dhe tematikave të natyrës, që janë mbizotëruese në galerinë e tij. Një rol të rëndësishëm në këtë aspekt ka luajtur pjesëmarrja në Kolonitë e Artit në Shqipëri, të zhvilluara në qytete të ndryshme, Kolonjë, Korçë, Vlorë, Shkodër e më tej, me disa nga figurat më përfaqësuese të pikturës shqiptare, si Buron Kaceli, Sadik Kasa, Pashk Përvathi etj. I cilëson dobiprurëse në aspektin e frymëzimit dhe krijimtarisë, por edhe të rritjes profesionale, ku mëson teknika dhe modele të reja. “Kur shoqërohesh dhe punon me piktore të tjerë kupton dhe mëson shumë nga gjithë procesi i krijimtarisë së secilit artist. Kupton si përzien bojën, si mban penelin, si qëndron përballë telajos, si zgjedh kompozimin e veprës apo si zgjedh frame-in në pikturën e tij”, thekson Davidi, duke shtuar se jo çdo peizazh merr të njëjtën kohë apo të njëjtin trajtim.

Në rastin e peizazheve apo tematikave të natyrës i duhet një ose dy ditë për ta përfunduar, por dita e dytë vjen me rrezikun e saj. Siç thotë edhe shprehja e lashtë “nuk mund të prekësh dy herë të njëjtin ujë”, vështirë se të njëjtën pamje e përjeton njëlloj për të dytën herë. “Nuk e preferoj shumë sepse ndryshon atmosfera nga një ditë në tjetrën, për rrjedhojë më ndryshon edhe shprehja e gjithë pikturës”, shton Davidi.

Përpiqet që në peizazhet e tij të vendosë një element që e identifikon me zonën apo qytetin ku po pikturon. Kjo e bën më domethënëse, por edhe më të preferueshme. Shumë nga klientët e tij zgjedhin peizazhe që u kujtojnë origjinën, krahinën apo qytetin ku jetojnë, e të tjerë i zgjedhin për arredim në varësi të kombinimit të ngjyrave.

Në rastin e portreteve, që shumë piktore e konsiderojnë një zhanër të vështirë, Davidi thotë se përplekja e tij më e madhe është gjetja e një elementi që përcjell një gjendje të caktuar, lumturi, habi, mërzitje, kureshtje. Prandaj i kushton mjaft rëndësi pjesës përgatitore, duke marrë sa më shumë informacione nga personi që porositi portretin. Ka qenë gjith-

monë i hapur ndaj sugjerimeve që i japin kolegët, mentorët, qoftë edhe njerëzit e thjeshtë, mendimin e të cilëve e veçon nga të tjerët. Këto sugjerime nuk i heqin asnjë presje talentit dhe egos së një artisti, përveçse mund të bëhen indicie drejt leximeve dhe interpretimeve të reja.

Njohjen dhe analizën e piktoreve dhe pikturës e ka bërë shumicën e kohës përmes vizitave në muze, kryesisht atyre në Europë, ku kontakti me kulturën është gjithmonë prezent. Italia mbetet vendi i preferuar, të cilën e viziton gjithmonë kur i jepet mundësia, arti dhe kultura e së cilës gjendet nga cepi në cep, me themele që shtrihen deri në Romën e Lashtë. Pjesëmarrja në Bienale dhe ekspozita ndërkombëtare ka qenë një tjetër mënyrë për të bashkëjetuar me artin ndërkombëtar. Vitet e fundit është prezantuar në dy të tilla të zhvilluara në Itali dhe Spanjë.

Sa më shumë që lexon dhe njej procesin apo teknikat e piktoreve, mjeshtrave më të mëdhenj të të gjitha kohërave dhe rrymave të artit pamor, klasikë apo bashkëkohorë, aq më tepër përpiqet të krijojë individualitetin e të dalë emër i përveçëm. “Ka raste kur e filloj diku një pikturë dhe nëse nuk më pëlqen si del e mbaroj pastaj në studio. Ose mund të bëj skica, piktura të vogla dhe pastaj i përdor si referencë”, thotë 23-vjeçari.

Shpesh përdor një aparat të vjetër, me rezolucion të ulët, për të fotografuar subjektet e tij. Kjo nuk është vetëm metodë, por edhe sprovë për të tejkuluar origjinalin dhe për të treguar artin e tij që e kategorizon, si një miks mes impresionizmit, shprehur më qartë te peizazhet, dhe modernes të përzierë me abstraksionizmin. Pranon se nuk do ta merrte kurrë guximin të injoronte klasiken, e cila mbetet e përrjetshme, gjendet kudo dhe nuk del kurrë nga moda.

### **Mes pikturës, inxhinierisë dhe mësimdhënies**

Prej gati dy muajsh koha e qëndrimit në studio nuk është mjaftueshëm e gjatë, por prania është e përditshme. Jo gjithmonë pikturon. Herë shikon një fotografi, herë një veprë në proces, e herë të tjera vëzhgon një punim të mbaruar, parë tashmë me syrin e ftohtë të piktorit që shkëputet nga autori, për të bërë aty-këtu ndërhyrje apo për të dhënë dorën e fundit. “Piktura kështu është, po e le një herë ti ajo të lë dhjetë herë”, thotë Davidi. Pavarësisht dëshirës për të qenë gjithmonë në vendin ‘magjik’, angazhimet profesionale janë shtuar pas mbarimit të studimeve master në Inxhinieri Elektrike. Paralelisht me ushtrimin e profesionit në fushën e biznesit, mori iniciativën për t’u përfshirë në mësimdhënie. Aktualisht është pedagog pranë Tirana College of Technology ku jep lëndët “Instalimet elektrike në banesa” dhe “Impiantet elektrike” në

programet profesionale 2-vjeçare që ky kolegji ofron prej dhjetë vitesh. “Mësimdhënien e kam me pasion. Ndoshta e kam marrë pak nga familja sepse kam shumë familjarë mësues dhe pedagogë”, thotë me të qeshur. Pavarësisht moshës së re, të krahasueshme apo më të vogël se studentët, Davidi ka ditur të menaxhojë si duhet auditorin me gati 30 studentë. Një pjesë e suksesit është disiplina, serioziteti dhe rregulli që imponon dhe pjesa tjetër është në meritën e studentëve të cilët janë mjaft të fokusuar në qëllimin e tyre, të marrjes sa më shpejt të një zanati dhe daljes në tregun e punës.

Nuk erdhi me ndonjë pritshmëri të caktuar në auditor, por vijueshmëria rezultoi mjaft pozitive. Aq sa herë pas here ndjen një farë ‘keqardhje’ për pikturën, për shkak se leximet ndaj saj tashmë kanë kaluar në plan të dytë. Pavarësisht kësaj, e mesmja aristoteliane merr frerin dhe vendos qetësinë në “mbretërinë kaotike” të artit dhe shkencës. “Unë i vendos kufij vetes dhe orare të qarta punës. Piktura s’ka orar, gjithmonë që kam pak kohë shkoj në studio dhe merrem me diçka”, tregon Davidi.

### **Çfarë i bën IA një piktore të 2025-ës?**

“Asnjë gjë”, thotë Davidi, i bindur se Inteligjenca Artificiale nuk ndikon aspak në artin e tij. E para sepse nuk mundet të imitojë konceptin, talentin, por mbi të gjitha sepse nuk e njej gabimin njerëzor, thënë ndryshe joperfeksionizmin. “Gabimi është autentik dhe qëndron mjaft bukur te puna e njeriut.” Edhe pse teknologjia ka avancuar në mënyrë të paimagjinueshme, duke prodhuar vepra me teknika të avancuara, ato sërish mbeten të pakrahasueshme me dorën njerëzore e aq më tepër me kryeveprat njerëzore që rrjedhin nga brezi në brez dhe nga një shekull në tjetrin. Arti dhe shija është subjektive, po ashtu mundësitë apo qëllimet, kështu që konsumi është pjesë e njerëzimit dhe vepra të tillë teknologjike bëjnë jetën e tyre. Davidi thotë se nuk e ka shqetësuar aspak avancimi teknologjik sa i përket krijimtarisë, e aq më pak zëvendësimi prej saj. Por ama ka parë mjaft të mira prej saj, për të gjetur artdashësit dhe klientelën e tij në Shqipëri dhe diasporë, pasi mjaft të shumë janë shqiptarët që jetojnë jashtë dhe porosisin piktura me tematika kombëtare për të marrë kështu me vete një copë nga atdheu i tyre. Rrjetet sociale kanë qenë për të agjenti më i mirë, pa shumë kosto dhe mundime, por me përfitime të kënaqshme. Shumë nga klientët që blejnë krijimtarinë e tij informohen nga punimet e paraqitura online, në Facebook apo Instagram. Pjesa tjetër njihet në studion ose nga ekspozimet që ai bën në ambientet e lokaleve të kryeqytetit. Sigurisht, marketingu i fjalës, më i lashti e më ndikuesi, nuk del kurrë nga moda.



## “Dasma Shkodrane” thesari i Kol Idromenos që tregon gjithçka në një kuadrat


“Dasma Shkodrane” piktura është ideuar nga gjeniu i pikturës sonë si një nderim për ceremonialin e dasmës shqiptare. Kuadron pjesën më emocionale të një rituali martesor shqiptar: shoqërimin e nuses nga shtëpia e saj. Gëzimi i familjarëve, fqinjëve dhe pjesëmarrësve vihet re lehtësisht falë aftësive mahnitëse të një prej piktoreve më të shquar shqiptar, Kol Idromenos Jo vetëm kaq, në përmasat 471 × 338 paraqitet gjithçka, çitjanet dhe ngjyrat e veshjeve të grave, ku shfaqen të paktën gjashtë costume, ndoshta të ndara sipas moshës. E bardha e ndërthurur bukur me blunë, apo dhe e kuqa. Më tej po aty shikon dhe komunikimin mes brezave ku vajzat sho-

hin me respekt gratë të cilat po ashtu përshëndesin me kokë e të gëzuara. Qëndrimi i burrave veshjet e tyre, të tregojnë pa fjalë gjithçka, krenari e mikëpritje. Shtëpia dy katëshe e mbushur me dasmorë që shijojnë gjithçka. Rrugët e kalldrëmta, minaretë dhe pastërtia e pasqyruar në pikturë tregojnë gjithçka për qytetin e kulturës. Tabloja u përfundua në vitin 1924, pasi kishte marrë pesë vjet punë të vazhdueshme dhe delikate. Veprat e mëdha kërkojnë punë, vullnet dhe talent. Kjo pikturë me të drejtë konsiderohet sot një “thesar etnografik” i artit shqiptar. Për veprën e artit antropologjisti amerikan Clifford James Geertz shkruan se është një mekanizëm i zhvillu-



ar për të përcaktuar marrëdhëniet shoqërore, për të mbështetur rregullat dhe për të forcuar vlerat shoqërore. Sipas tij, kur studiojmë një formë të artit, ne eksplorojmë një ndjeshmëri, e cila në thelb është një formacion kolektiv, pasi themelet e një formacioni të tillë janë aq të gjëra e aq të thella sa është qënësia shoqërore. Kolë Arsen Idromeno, 1860 – 1939, ishte një ndër artistët më të rëndësishëm të Rilindjes shqiptare. Ai kreu mësimet fillore në Shkollën Françeskane në Shkodër dhe ato private për pikturë dhe arkitekturë tek mjeshtrit Pietro Marubbi, Fra Anselmi dhe Fra Mascheni. Vetëm 15 vjeç ai u dërgua në Akademinë e Venedikut për të vazhduar mësimet në Artet Figurative. Pas kthimit në vendlindje rreth 1878, Kolën, përveç pikturës, e tërhiqte mjaft fotografia, të cilën e shihte me kënaqësi në studion e Marubit. Duke parë aftësitë e të birit në fotografi, Arsen Idromeno vendosi të hapë së bashku me të një atelie fotografike. Punën do ta drejtonte Kola me një pasion të madh si artist dhe te-

knolog në proceset e fotografimit. Studioja e ngritur në oborrin e pasmë të shtëpisë, u quajt “Dritëshkronja e Kolës”. Gjatë punës si fotograf, Kola lidhi miqësi me njerëz të të gjitha shtresave, duke u bërë kështu njeri i njohur në qytet si piktor, arkitekt, urbanist, fotograf, skenograf, muzikant e kompozitor këngësh shkodrane. Ai ishte ndër të parët që realizuan shfaqje kinematografike në Shqipëri. Pas Kol Idromenos, arti mori një drejtim thellësisht të ri. Është momenti që një art aplikohet larg kanoneve ikonografike bizantine dhe pasbizantine. Filluan të trajtohen me realizëm të thellë e frymë romantike subjekte dhe motive nga jeta reale. Këto subjekte bazohen në perceptime folklorike dhe etnografike”, ka shkruar Abaz Hado. Ai ka theksuar se te “Motra Tone”, ajo që i ka dhënë veçantësi, “është pozicioni i duarve plot elegancë dhe bukuri, apo kapje e degermisë së bardhë, për të na dhënë në këtë mënyrë, mundësinë të zbulojmë fytyrën e ëmbël të një vajze të bukur 24-vjeçare”.



## 100 FIGURA HISTORIKE NË PIKTURËN SHQIPTARE\*

### Skënderbeu, heroi kombëtar në pikturën shqiptare dhe evropiane

Heroi kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu është padyshim figura historike më e pranishme në pikturën shqiptare dhe një nga figurat më të trajtuara edhe në artin evropian. Portretet dhe paraqitjet e tij janë të ekspozuara në mbi 20 shtete, si në galeri publike, ashtu edhe në koleksione private. Ndër paraqitjet më të hershme dhe më të rëndësishme grafike të Skënderbeut është gravura e vitit 1596, e realizuar nga Aliprandino Caprioli, gdhendës italian i lindur në Trento dhe aktiv në Romë në fund të shekullit XVI. Në këtë gravurë shfaqet qartë stema e Skënderbeut dhe e familjes Kastrioti: shqiponja dykrerëshe e kurorëzuar me dy kurora princërore dhe ylli gjashtëcepësh mes dy kokave të shqiponjës, simbol që gjendet edhe në vulën origjinale të Skënderbeut. Para tij ka dhe piktura të tjera, por ende ka debat për autorësinë e tyre.

*\*Pjesë e projektit UET-UETPress për historinë e artit*

# M

# MADAME

SUPLEMENT  
PËRFEMINIZMIN

**ALBA ALISHANI**  
Moderatorja që nuk  
bën kompromis me  
profesionin!

**OLLGA PLUMBI**  
Gruaja që foli kundër  
patriarkanizmit prej  
1936 e mbrojti  
emancipimin e gruas  
në komunizëm

**100 GRA NË PIKTURËN  
SHQIPTARE**  
Motrat Zengo  
piktoret e para  
profesioniste në  
Shqipëri

# ELSA BALLAURI

## Shqipëria ka nevojë për dashuri





# ELSA BALLAURI

## Shqipëria ka nevojë për dashuri

Intervista, Elsa Ballauri: Muzeu i gruas ka ardhur si një nevojë e fshehur pas një pasioni. Duhet një lëvizje për të rinjtë

**E**lsa Ballauri, një nga figurat më të njohura dhe të përkushtuara në Shqipëri për të drejtat e grave, barazisë gjinore dhe edukimin e të rinjve. Me një eksperiencë të gjatë në aktivizëm dhe punë me komunitetet e ndryshme, ajo ka kontribuar në ngritjen e ndërgjegjësimit për çështjet gjinore dhe në formimin e brezave të rinj si qytetarë të vetëdijshëm dhe aktivë.

Në intervistën më poshtë Ballauri ndan përvojat e saj, sfidat e shoqërisë shqiptare dhe mendimet mbi rolin e të rinjve, ndikimin e rrjeteve sociale dhe rëndësinë e lëvizjeve të vërteta për të drejtat e grave.

***Si e vlerësoni rolin e të rinjve sot në lëvizjet për të drejtat e grave dhe barazi gjinore? A janë duke u angazhuar mjaftueshëm ata, sipas jush?***

Nuk jam pozitive në lidhje me këtë pyetje. Mendoj që nuk kemi ende në Shqipëri një lëvizje rinore apo të grave për të drejtat e tyre apo për diskutime të gjera në lidhje me këto çështje. Këtu po përfshij edhe diskutimin mbi barazinë gjinore. Ka shumë vite që nuk shoh tendencë për stabilitet të një filozofie për t'i debatuar dhe për të folur mbi problemet tona. Nuk ka iniciativa sidomos nga të rinj dhe të reja. Edhe kur ndodhin, ato janë të vogla,

private, por të paafta të gjenerojnë frymë. Ne nuk kemi lëvizje të grave apo lëvizje të të rinjve, shoqëria jonë është shumë apatike për këto. Ka projekte grash, individë të suksesshëm, ka shoqata grash, por lëvizja është shumë e dobët.

Ju më pyesni për lëvizje mbi çështjen e barazisë gjinore. Kjo nuk ishte lëvizje, debati u hap vetëm në media dhe vetëm nga media, shpesh nga gazetarë që nuk e kuptojnë ose janë të interesuar vetëm për shoë. Si edhe herë të tjera, shumë individë bien në kurthin e fasadës dhe s'kanë mundur të shpjegojnë qëndrimet e tyre. Shoqëria civile apo individë

që kuptojnë se ç' do të thotë "lëvizje", duhej ta kishin nisur diskutimin mbi këto çështje shumë më herët dhe duhej të ishin ata që do t'i imponoheshin parlamentarëve apo me diave.

**Rrjetet sociale, sidomos platformat si TikTok, Instagram apo X (Tëitter), sa ndikim kanë sipas jush në ndërgjegjësimin për të drejtat e grave dhe lëvizjet gjinore në Shqipëri?**

Platformat e shpejta, si këto që përmendët, nuk ndikojnë aq sa duhet dhe si duhet. Madje shpesh çorientojnë logjikën dhe minimizojnë debatin. Nëse do dish t'i përdorësh siç duhet, ato mund të jenë ndihmesë e mirë, dhe këtu flas për rastet e ndodhura të shkeljeve, dhunës ndaj grave, ngjarje reale që i bëjnë njerëzit më të ndjeshëm, si edhe opinione të shkurtra nga ekspertët. Mirëpo ato, mendoj se, ose janë të rralla mes mijëra postimeve të kota, ose janë të pamjaftueshme për të ngritur debat konstruktiv.

Unë nuk jam një ndjekëse e këtyre platformave, por nga eksperiencia mund të them se lëvizja për të drejtat e grave dhe çdo lloj lëvizjeje tjetër ka nevojë për diskutime të vërteta, ku njerëzit shohin njëri-tjetrin në sy ndër kohë që kanë marrë përsipër një mision: të jenë pjesë e vërtetë e këtyre lëvizjeve. Rrjetet sociale nuk krijojnë dot lëvizje; ato mund të krijojnë vetëm frymë thashethemesh.

**Keni themeluar Muzeun e Gruas në Tiranë, përmes të cilit promovoni historinë gjinore në Shqipëri. Cilat janë këto histori dhe çfarë do të veçonit si një sukses të nismës suaj unike?**

Muzeu i gruas ka ardhur si një nevojë e fshehur pas një pasioni, siç është ai i koleksionimit. Për vite të tëra jam e dashuruar pas këtij hobi dhe erdhi një moment kur hobi u bë detyrë, dhe detyra ishte e lidhur me atë mision për të cilin punoj prej vitesh: të drejtat e njeriut. Kur flasim për gratë, kemi folur

për gjithë shoqërinë, kemi folur për burrin, fëmijët, familjen, historinë, kombin.

Qëllimi im dhe i muzeut është të zbulojmë historinë e grave në Shqipëri, atë histori që komunizmi e fshiu ose e keqpërdori. Është punë e vështirë, por e mrekullueshme. Vitet e para të diktaturës nuk i njohim pothuajse fare, vitet e diktaturës akoma nuk kemi filluar t'i debatojmë siç duhet. Mbetemi fasadistë, por kjo nuk do të thotë që të mos ndryshohet.

Sukses? Unë çdo ditë në muze e shoh me optimizëm; sukcesi vjen pas çdo informacioni të ri që zbulojmë. Viti që vjen do të prezantojë gjetje shumë interesante dhe unë do të kem një podcast për mbledhjen e dëshmimeve të grave, sepse jeta ikën shpejt dhe kujtimet na humbin çdo ditë.

**Mendoni se sot vajzat dhe gratë në Shqipëri janë më të diskriminuara se ato në rajon dhe më gjerë?**

Situata e grave në Shqipëri ka ndryshuar shumë. Ato janë më të sigurta, më të ndërgjegjësuara, janë në gjendje të ankohen për dhunën apo padrejtësitë, janë të angazhuara dhe sidomos janë të talentuara për të bërë bizneset e tyre. Por nuk kanë ndihmë. Ashtu si në kohën e diktaturës ishin të mbingarkuara me dhunën e shtetit dhe të patriarkisë, ashtu edhe sot, shtetin nuk e kanë një suport të sigurt dhe patriarkia vazhdon, shpesh e kamufluar.

Gratë shqiptare, si edhe ato në botë, kanë të njëjtat çështje për të zgjidhur: dhunën, diskriminimin, patriarkalizmin – dhe këto janë kryesisht debatet publike. Mendoj se ajo për të cilën duhet të flasim më shumë është si të shkëputen nga "modeli i gruas", si të mos pengojnë veten e tyre, si të ndjekin agjendën e tyre dhe jo atë të burrave. Edhe të shohin fajin brenda vetes dhe ta pranojnë atë, që në momentin kur bëjnë ndarjen e punëve të shtëpisë dhe i konsiderojnë meshkujt e familjes si mbretër dhe veten si shërbëto.



Këto janë disa nga diskutimet që bëjmë me të rinjtë dhe mendoj se ia vlejnë.

**Nuk kemi ende një grua shqiptare në postin e Presidentit ose të Kryeministrit. A mendoni se edhe kjo është tregues diskriminimi?**

Unë do të thosha që ky është tregues diskriminimi dhe vetë-diskriminimi. Shqipëria është në listën e vendeve konservatore. Natyrisht burrat nuk duan ta humbin dominancën politike; edhe kur tregohen ndryshe, i përdorin gratë për përfitimin e tyre. Këtë model mund ta përmbysin vetëm gratë, me diplomaci, me qetësi dhe duke ndërtuar karrierat e tyre politike. Sigurisht kjo kërkon shumë energji, sfida dhe shumë punë, por kështu ka ndodhur në vendet që ne i marrim si model... Është e vështirë, por jo e pamundur.

**Supozojmë se një ditë do të ishit ju në postin e kryeministres. Çfarë do të donit t'i ndryshonit Shqipërisë?**

Shqipëria ka nevojë për dashuri... Do të bëja të pamundurën që shqiptarët të mësohen të duan vendin e tyre, të duan veten. Do të bëja të pamundurën që shqiptarët të ndiheshin dinjitozë dhe të sigurt. Për këtë duhet t'u shërbesh njerëzve, t'i respektosh, të kujdesesh për ta, t'i duash... Dhe më tej mund të them formula shumë të bukura dhe të vështira, si: zbatimi i ligjit, lufta ndaj korrupsionit, ndarja e pushteteve dhe respektimi i institucioneve, zgjedhje të ndershme, etj. Rregullat e mira krijojnë edhe elita të shëndetshme. Vetëm një qeverisje e mirë dhe për njerëzit e bën të mundur këtë. Larg parave të dyshimta dhe njerëzve që nuk krijojnë modelin e qytetarit të vërtetë. Ka shumë mënyra se si të arrihet lumturinë dhe sigurinë e një populli. Unë mendoj se nëse e ke këtë pikësynim, ja arrin ta realizosh. Në këto situata, do të shohim se edhe gratë do të kandidojnë për poste të larta pa patericat e burrave.





# OLLGA PLUMBI

## Gruaja që foli kundër patriarkanizmit prej 1936 e mbrojti emancipimin e gruas në komunizëm

**O**llga Plumbi lindi në vitin 1898 në fshatin Lupckë të Përmetit, në një familje intelektuale. Babai i saj, Zahari Leka, ishte mjek i arsimuar në Francë, ndërsa nëna Polikseni kishte studiuar në shkollën Arsaqion të Athinës. Fëmijërinë e kaloi kryesisht në qytetin e Përmetit, në një mjedis librash dhe dashurie për kombin, që ndikoi shumë në formimin e saj.

Ende e re, Ollga u martua me mësuesin dhe aktivistin Mihal Plumbi. Pas vdekjes së parakohshme të bashkëshortit, ajo u detyrua të emigronte në Perëndim për të mbajtur familjen. Në mesin e viteve 1930 u kthye në atdhe dhe u përfshi në trupën arsimore të kolegjit amerikan “Kenedi” dhe në Liceun Francez, ku u bë fanar i edukimit për vajzat shqiptare.

Përveç mësimeve, Ollga nisi të shkruante për gjendjen politike, shoqërore dhe kulturën e gruas shqiptare. Ajo bashkëpunoi me revistën “Bota e Re” në Korçë, në një grup me shkrimtarët progresistë Migjeni dhe Selim Shpuza. Në vitet 1937-1939, nën pseudonimin Shpresa, botoi një sërë artikujsh mbi feminizmin në revistën “Përpyjekja Shqiptare”, duke u bërë një nga gratë e para publiciste që trajtoi çështjet e grave.

Në artikullin “Feminizmi dhe shoqëria” të vitit 1936, Ollga denoncoi familjen patriarkale dhe deklaroi se një shoqëri nuk mund të quhet e qytetëruar nëse vazhdon të adhurojë modelin ku burri është “zot” dhe gruaja skllave. Ajo i quajti gratë “viktima të fatit” dhe kërkoi emancipim: shoqëria e re duhet ta shohë gruan të pavarur, të sinqertë dhe të çliruar nga kufizimet tiranike familjare. Për të, zhvillimi shoqëror ishte i pamundur pa dijen dhe arsimimin e femrave.

Me pushtimin e vendit, Ollga nuk qëndroi në hije. Ajo u bashkua me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe mori pjesë aktive në Konferencën e dytë Nacionalçlirimtare, ku kontribuoi në mobilizimin e grave. Si kryetare e Bashkimit të Grave Antifashiste të Tiranës, krijoi një rrjet solidariteti që lidhte nënat, motrat dhe bashkëshortet me idealin e çlirimit.

Pas Luftës së Dytë Botërore, roli i saj u njoh gjerësisht.

Në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, ajo fitoi një numër të lartë votash dhe u zgjodh deputete, duke qenë e dyta më e votuar pas Enver Hoxhës. Në parlament mori postin e nënkryetares së Presidiumit të Kuvendit Popullor, duke sjellë zërin e grave në institucionet shtetërore. Por në vitin 1946 u shkarkua nga detyra dhe u zëvendësua nga Nexhmije Hoxha, sepse nuk ishte anëtare e Partisë Komuniste; që prej asaj kohe u përjashtua nga jeta politike.

Më pas punoi si shefe e marrëdhënieve me jashtë në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës dhe doli në pension, duke iu përkushtuar leximit dhe studimit. Në vilën e saj në Rrugën e Kavajës krijoi një bibliotekë të pasur me libra në disa gjuhë; miqtë tregonin se syri i tyre mbetej te raftet e librave ndërsa ajo ndante historitë e saj. Pavarësisht njohurive të gjera, Ollga njihej për modestinë; ajo besonte se fuqia e grave qëndronte në dijen dhe qetësinë e tyre.

Në vitet 1950, themeloi dhe drejtoi revistën “Gruaja Shqiptare”, ku botoi me pseudonimin “Zita” artikuj që trajtonin të drejtat e grave dhe reformën familjare. Idetë e saj për barazinë gjinore, progresin kombëtar dhe liritë familjare ishin shumë përpara kohës dhe shpesh përballëshin me opinionin obskurantist. Ajo përsëriste se liria e Shqipërisë nuk mund të arrihej pa emancipimin e graver.

Djali i saj, Emil Plumbi, u bë kryeinxhinier i Radio Tiranës dhe ruante mesazhet e nënës se liria lidhet gjithmonë me dijen. Fjalimet e saj në Kuvend dhe shkrimet e viteve ’30 janë thirrje të vazhdueshme që vajzat dhe nënat të mos mbeten “objekt” por aktore të barabarta në jetën publike.

Edhe pse pas viteve ’50 u hesht nga regjimi, figura e Ollga Plumbit po rizbulohet sot si një nga pionieret e feminizmit shqiptar. Ajo u nda nga jeta në vitin 1984, duke lënë pas një trashëgimi të çmuar shkrimesh, kontributesh antifashiste dhe frymëzimi të pashuar për të drejtat e grave. Sot, historianët e përmendin si një grua të së ardhmes; kujtimi i saj vazhdon të frymëzojë breza që besojnë se Shqipëria nuk mund të jetë e lirë pa barazinë dhe edukimin e grave.



## 100 GRA NË PIKTURËN SHQIPTARE\*

### Motrat Zengo piktoret e para profesioniste në Shqipëri

Artistet gra janë pa dyshim të cilat kanë kontribuar pikërisht për këtë gjë, pra e kanë bërë artin Shqiptar më poetik më të bukur, më të ndjerë, dhe jashtë skenave, të periudhave të komunizmit. “Motrat Zengo” janë ndër pioneret e para. Trashëguan artin e babait të tyre Vangjel Zengo dhe studiuan në Greqi. Në vitin 1936-tën hapën ekspozita në Shqipëri me 60 punime. Sofia Zengo realizon vepra me ngarkesë të fortë emocionale dhe introspektive: “Gruaja me shall”, “Autoportret”, “Portretet fshatareje”. Sofia Zengo la pas qindra piktura në vaj, kryesisht portrete dhe peizazhe.

*\*Pjesë e projektit UET-UETPress për historinë e feminizmit*